Xhemajl Rudi

LULE DHE VJESHTË

TRINGA DESIGN

Xhemajl Rudi

LULE DHE VJESHTË

Poezi

Biblioteka

Botimet Shqiptare

Editor dhe redaktor biblioteke

Enver Neziri

Recensentë

Salajdin Salihi

Lirim Alija

Redaktore gjuhësore dhe lektore

Vjollcë Berisha

Përgatitja kompjuterike

Selajdin Latifi

Kopertina

Salajdin Salihi

Xhemajl Rudi

LULE DHE VJESHTË

Poezi

Tringa Design
Tetovë
2011



Xhemajl Rudi

LEGJENDA

Njëherë magjia e hyjnisë ishte pylli
e në pyll ishte dritësimi
atje sipër shkëmbit
te kaltërsia e qiellit
te qielli i shqipeve
dhe një lumë atje derdhej në grykë
te rrënjet e thella nën mal
dhe tingulli mbi rrasën e gurit
ishin gjurmët e hapave të kohës
magjishëm dhe zëri i hyjnisë
ishte e madhe dashuria e pyllit
fytyra në rrezen e jetës
pamja e saj shkrihej në shkëlqimin e syve
dhe zogjtë cicëronin si gjethet
dhe zemra ndihej si në buzët e qiellit
si vetë shpirti i tij n`dritësimin e jetës
në legjendë u bekuan të gjitha njëherësh
në çdo hap të njeriut sipër balte,
në gurra gurësh dhe drite
Më pas kujtimi sublim i dashurisë
dhe hardhia te guri dhe tingulli si shenja të dehura të kohës

ATJE

Atje lart mbi bregore
të blerimit
cicërojnë zogjtë e kaltër t`qiellit
këngën e kthimit
Në shkëlqim t`yllit
të ditës
e bardha dritë vjen e duket
si te lisat nën qiparis
si një hije n`shenjë kujtimi
aty te lugjet hone krojesh
ngjyrë e verdhë, e ngjyrë e vjollcës
Një kurorë fushe dhe mali
janë si rrugët në një zgjim
ku fillojnë n`shkëlqim të dritës
tu u shtri në pambarim
Shkulet nata, hija mbetet
sikur lisat n`qiparis
si një gur sipër gurësh
sipër kohës përmbi kohe
sikur shekulli përmbi shekull
sikur ditët sipër javësh
rrotullohen si hendekut
njëri lart e tjetri poshtë
si një rreth i blertë i honit

si bregore sipër blerimit
shenja cicërima zogjsh
vajtje-ardhje
zëri kënga hija n`dhimbje
sikur stinët në rreth magjik
sikur drita në blerim
atje te bregu,te hija e kohës
është shtrirë honit nën qiparis

VETËM TY

Vetem ty të shoh
si dukesh dhe humb përsëri
o fjala jote prej hyjnie
pamja jote prej drite të mirë
drita e emrit tënd e pashqiptueme asnjëherë
As atëherë as tani as kurrë
si dehja je e zgjueme e jetës
ndritë në xixa t'u u shfaqë e t'u u tretë ndër sy
përseritesh ditëve të mia si asnjëherë
Oh, ti e vërteta e ëndrrës së mirë
Oh, ti gëzimi i çasteve të mia mbi të hirtën e përditshme
Oh, ti kurorë e hyjnisë e natës dhe e ditës
Oh,ti që përfton në emrin tënd në të gjitha errësirat
Ti që vetëm dukesh dhe fshihesh përsëri ndër sy
dhe vesën e lë t'u ju shkri në ndjesi të jetës
atje sipër malit, sipër reve të shkëmbit si petale shkëlqimi të kaltër
Oh, ti emër i shfaqur, që ndrit përditë e përnatë, e prarueme si valët e lumit
Oh, ti që digjesh në pamjen tënde, fjalën dhe guximin tënd të pafund
Dhe unë të falem vetëm ty, deri në agimet tona të hyjnisë të dritës e te emrit tënd

ÇELI LULJA NË DRITARE

çeli lulja në mëngjes
te dritarja afër xhamit
puthte dritën e agimit
rritej rrezes t'u u shtri

Atje ishte sipër udhe
në ballkonin e shtëpisë
në një vazo n`vija qielli
syth i saj vjen e ndrit

Po hapej lulja në dritare
sikur xhami n`diell shkëlqen
është një lule shtrirë në erë
syth i saj si rreze n`qiell

Lule-bukur, lule-jete
si një gocë e brishtë e d`lirë
pranë xhamit si dy gërsheta
fytyra e saj e prarueme erëmirë

çeli lulja në dritare, afër xhamit n`erë puhit
tinguj qielli, n`pika drite, sythit rrjedhin plot shkëlqim
lulebukur, lulejete, si një gocë e brishë e d`lirë
është n`petale shtrirë në erë, syth i saj si rreze n`qiell.

LUTJET

Lutej dje, lutet sot,
lutet si përditë
për sytë e saj, fjalën e saj,
ëndrrën e saj.
Lutet, lutet, vetëm lutet,
si pranë lules n`dritë të hënës.
Ajo lutet dhe ai lutet,
të dytë luten, të dytë thonë;
o qiell i madh, n`ëndërr të kaltër,
që te ti pushojnë të gjithë,
që te ti fshajnë të gjithë
që te ti vdesin përditë
që te ti lindin si yjet
që te ti n`ëndrra të jetës
që te ti duan të treten
në zjarrin tënd të gjithë të digjen
n`yllin tënd të gjithë të mbeten
n`yllin tënd prapë të vijnë
n`yllin tënd vesë të bëhen
n`yllin tënd mëngjes të lindin
n`dritën tënde lule të çelin
n`dritën tënde petale hëne
n`driten tënde tokë e shtrirë
n`dritën tënde ngjyrë më n`ngjyrë

n`trëndafil e n`margaritë t'u u rritë e t'u u shtri
n`trëndafil e n`margaritë t'u u mbulu në një dritë
si një vesë jete në tokë, në qiell e në hënë,
e në yje si lule jete në të purpurtën e paanë
Lutej ai, lutet ajo, si një zjarr mbi prush të shprushur
ditë për ditë e natë për natë, në një fjalë në dritë të tyre, në një flakë
dhe më pas në sy të jetës, si pas zjarrit pikon vesë
Pikon shpresë në vesë mëngjesi, lule më lule vesë pikëllimi,
pikon vesa përmbi vesë, në lule toke, në lule hëne, e lule diell, si lule yjet, në lule qielli

TE TI VIJA PËRDITË

Përditë vija te ti, të isha më pranë
me dëshirë e me gëzim të madh
sepse ti shkëlqeje si zjarr i zemrës
dhe lëndohesha përditë në pamjen tënde
dhe vija me plagët e dritës, si tani, si druri i etur
E ti largoheshe larg, shumë larg,
dhe pikoje dritë në shenja të dhimbjes,
dhe ndizeshin dhe shuheshin pa pra
si xixëllonjë e natës ishe sipër arave me grurë.
Kërkoja me fanar të të gjeja vetëm ty
dhe vetëm ty të lutesha, nën dritën e syve të zemrës
si në tempullin e të gjitha dashurive,
të kaltërsisë qiellore, e në ngjyrën e verdhë
te blerimi i kodrave dhe mbi thepin e shkëmbit.
Përditë të vija më afër, më pranë teje doja të isha përditë
si një pasqyrë të dytë ku mund ta shihnim njëri-tjetrin
ku mund të flisnim dhe mund të luteshim bashkë,
si xixëllonja që duket dhe humb në flakën e vet përsëri.
Oh, ti je si drita në erë të mbrëmjes
dhe unë vrapoj pas teje, pas zjarrit që e bartte përnatë
mbi fusha të gjera me grurë, mbi drunjë dhe mbi gjethe
ti je më afër se hëna, sepse pranë duarve të zemrës bart zjarrin tënd
Ti që afrohesh dhe largohesh pa fund dhe unë lutem për ty deri në ag.

TEJ MITEVE

Tokë e rrafshtë, e gjerë
me lugje, me hone,
me brigje pa fund
e një lumë rridhte si koha
pranë një ndërtese të vjetër
prej gurëve të rëndë
përzier me dheun prej bote
si n`rreth t`oxhakut
e gurët nxeheshin si zjarri
e ftoheshin si faqja e hirit
dhe vlonin kohë brenda dhe shekuj
si një pikë uji i njelmët në sy të flijimit
si një pikë uji të ëmbël të lumit të qetë
si valë trishtimi, si melodi stinësh
si vetë notat e tingujve të zemrës së mallit
si një pikë vese nga gjiri i nënës
në dorën e zgjatur të pritjes së kohës
si zogu i ringjallur, kur do të pikojë takimi i një dite
si gjirit të saj dëshira, jeta dhe sytë e të birit
dhe brigje dhe këngë dhe jehonë dhe zana
dhe pika uji dheu bote të mirë,
në guret mbi shenjat e dhimbjes
tej miteve janë të gjitha trishtimet,
të gjithë gëzimet, të gjitha fitoret,

të gjithë motet, tej flijimeve, tej hirit, tej zjarrit.
Tej dritës së parë të agimit të kohës,
dhe muzgjet janë kujtesë e ditës,
dhe varur si mbrëmjet në vigun e miteve,
e tej tyre janë gurët në dhimbjet e fjalës dhe flijimet

PËRDITËSI`RITMI

Përditë e njëjta dashuri,
përditë e njëjta fjalë.
E njëjta dhimbje në sytë tanë
si përditë, një boshësi në zemër.
Një lot kujtimi, në një lot gëzimi,
dhe djalli dhe engjëlli krah njëri-tjetrit.
E përditë një shpresë e re dhe një e thatë si dega,
një gjeth që bie e një që fluturon në erëra.
E ti thua përditë është e njëjta gjë,
përditë i njëjti ritëm, i njëjti shikim,
dhe si përditë s`ka ardhur te ne ndryshimi.
Dhe lulja s'u rrit, përditë ti thua se mbeti si dashuria e njëjtë
dhe vyshket e çelet prapë për t'u vyshkur.
I njëjti hap, i njëjti ritëm, e njëjta ditë
vetëm një gjë tani e dimë të dytë,
se përditë po shkojmë kah perëndimi
dhe sytë tanë andej na çojnë,
dhe zemra jonë po ashtu të njëjtën fjalë e thotë.
Dhe ditët tona çelin, duken dhe perëndojnë,
si sytë tanë, si dashuria, si jeta, si vetë bota jonë mbi ferra,
si vetë zjarri ku shuhet dhe prej hirit ndrit përsëri.
A s`të duket se përditë diçka po ndryshon?
E përditë s'është asnjëherë e njëjta gjë,
e ne na duket kështu, sepse ashtu është,

te ti dhe te unë, boshësia e syve të zemrës.
E shpirti ynë ritmin s'e do, as përsëritjen,
sepse ndryshimit ajo shkon si valëz deti pa pushim,
në atë që s'është kurrë si dita e njëjtë.
Dhe ne nuk e ndjejme se po perëndojmë,
si të gjitha gjërat e jetës dhe të botës së ftohtë.
E do shuhemi atje në perëndim, si përditë, ditëve tona.
Dhe më thuaj tani, a s'është si përditë te ne të dy ky ndryshim,
si buzëve në shkëlqimin e diellit
t'u u varë si vathët e jetës, të dy pas shpinës së natës.

NJË LULE-ÇASTI

Një çast ishte buzë lumi,
në ujë një syth sa filloi të çelë,
ngadalë e në ngjyrën e gurëve,
t'u u rritë e tuj u ndritë.
E vogël nën valët e ujit,
vjen t'u u rritë t'u dalë nëpër valë,
e vala në valë e lumit të bardhë.
E lulja i hapte petalet e reja,
e nën diell merrte ngjyrën e kaltër.
Nën ujë ishte në ngjyrën e gurit,
e pranë dheut ishte ngjyrë e blertë,
buzë mbrëmjes ishte ngjyrë e purpurt.
E në mëngjes ishte petale shtrirë
në dritë të bardhë,
si lumi rridhte, si vala në valë
e ngjyra e shkumës ishte e saj.
E shtatin e rriste si zambak i kaltër,
e sipër buzëve sythit të blertë
e puthte të kuqen në rrezeqiell,
e vetë si hëna strukej e brishtë,
dhe hija e saj, ndriste n`qerpik,
e qerpikut pikonte vesa në dritë.
Një çast ishte kur lulja u ngjiz,
në lumin me valë e në ngjyrë të gurit,

po çilte, po rritej në ngjyra t`ylberit.
Duke u kthyer si harku në skaje të jetës, lart sipër reve,
në ngjyrat e saj duke ndritë si premtim në shtatë vija të qiellit

SHTIZA E FJALËS

Një fjalë
në gjethin e vjeshtës.
E një tjetër fjalë
në gjethin e blertë.
E një është
në flamurin tim,
me ngjyrën fisnike
të vjetër sa motet,
dhe të pluhurosur.
Në shenjë ngushëllimi
të kohës,
e ulur, e leckosur
atje sipër është,
në gjysmështizën e Fjalës.
Te thepi i gurit në mal,
te dritarja ime,
sipër udhëve,
valëvitet fjala,
me erën e blertë.
Si ëndrrat e gjelbërta,
në ngjyrën e kaltër,
në gjysmështizën e verdhë,
në cepin e dritës e në honin e kohës.

E PURPURTA

E purpurt si ëndrra
në dritën e hënës
e mira, e bardha
si sythe petalesh
gjinjtë e saj të butë,
dritësojnë të arta
Trupi i saj i mirë
nën dritë të purpurt
dritëson si lule
Një lëkurë e bardhë si sythe jete
një fytyrë e plotë në bukuri petalesh
në trupin e saj, si ndriste dashuria
Si një yll të shkrihej në gjinjtë e saj
si zjarri, si flaka në fytyrë të jetës
shtrirë si petale në ngjyrë të dëlirë,
si një lulemirë, n`dritën e hënë.
Nata po ikte në kujtim të çastit
po ndriste dita pas zhytjes së hënës
te mëngjesi i mirë pas natës së kaluar
e dielli po varej te kepi në shkëmb
e rrezja po e puthte xhamin e dritares
e ndriste lulemollën, e më pas ra dritë e saj në kopësht.

RRUGËT

Rrugët janë të gjata pa fund
rrugët e dritës a të territ
apo nën neonet e natës së gjatë
aty pranë lumit, pranë ujit, aty pranë saj

Dhe në udhë janë pothuaj të gjithë
e në rrugica të ngushta, si katakombe
dhe skaje tortuaresh, sipër gurëve
si udhëve të qiellit pa fill e pa fund

E lumi i mbledh të gjitha burimet
dhe derdhet në degëzime përsëri
nga guvat e errëta të tokës e shkëmbinjve
ecën koha nën dritën e yjve

Dhe pranë saj, sa afër jemi, sa pranë lumit
udhëve tona dhe të dytë te vetëm
si pranë dritares si lulja e mëngjesit
ku çel në pragun e dritës e në sytë e agimit

Dhe në rrugë, udhëve pa fund, si krejt jeta udhë
lugje dhe brigje dhe përrockat ku rrjedhin ujërat mbi gurë
e pranë ujit ka zogj, ka gjelbërim, ka këngë
si pranë dritares kur fillon dashuria të marrë një udhë

Te ajo pikonte vesa si në petalet e lules
e në xhame shikimi vjen duke u tretë
si vetë dashuria prej qelqi, si vesa, si mëngjesi
dhe udhës drejt yjeve po ecnim pa fund

Brigjeve të lumit, në valët e qeta e herë në rrëmbim
drunj, gjelbërim dhe shushurima zogjsh
nëpër barin e gjelbër shtriheshin krahët si në fluturim
shenjat e takimit, si dritat e neoneve, si vesa në zgjim

NË BUFENË E BOHEMËVE

Në lagjen e bohemëve
është një kohë e lëndueme,
në dashuri të përsosur si vera në gotë.
Si gota e qelqit, në shkumën e birrës,
si këpucët e tyre të arnueme,
si veshjet e vjetra me arna kohe,
rrecka në arnime dhe në dinjitet të fjalës.
Në diellin e tyre bohemët qeshin dhe ngrohen,
në qiell janë si zogjtë ku fluturojnë të lirë,
e në sqepat e tyre është luleqielli.
Atje ku dita kurrë s`perëndon,
e në shkëlqim janë si ylli i dritës.
Atje ku syri i tyre i sheh të gjitha lëvizjet
e ngjyrave dhe tingujt e harmonisë,
dhe ylberin e gjithësisë në te gjitha kohët.
Atje ku vetem lindjet përsëriten,
e ngjizen në fillime, vështrojnë
aty ku fryma e tyre ka emër lirie.
Aty ku koha është e lëndueme,
e në lëndime të zhytur thellë dhimbjes,
në kafenenë pranë birrës
e verën në gotë dhe në bekimin e fjalës.
Në këpucët e rënda e të përbaltura,
rrecka të rënda e në vuajtje të trishtë,

në përbuzje të vrarë ndër faqe të skuqura,
si rrecka këmishe në rrudhat si brazda,
si në kocka të gishtërinjve dheu i gërryem.
E në koken e tyre ka zjarrmi e djersë,
pije në dehje, fyerje dhe grushtime të rënda,
gunga kanë, në sytë e tyre, në fytyrë të tyre,
si në këpucë të tyre, si në duart e tyre, të rënda të ashpra.
E zemra e tyre është e butë e mirë, si qeshja e ëmbël e ngjyrave
të blerta,
si vuajtja e tyre nën peshën e kohës e të reve të qiellit.
Si vetë vuajtjet, në pengun e moskuptimit te jetës, të fjalës
si vetë thirrjet e tyre në dehje të kohës, të fjalës e të lirisë.
Ata flisnin nën zhurmat e pijes,
e si nuk i shihni retë e kohës sa të errëta janë,
O, të verbrit e jetës së mugët,
në dashuri të humbur si mbrëmja jeni
dhe si ditët tuaja pa sy thonin si vetë mosshikimi
e në errësirën tuaj, tretur përditë jeni buzëve të varrit.
E pas tyre është një tjetër dritë që shkëlqen një jetë,
dhe s`e shihni mbrëmjen, as yllin e mëngjesit, as mesditën,
as vijën e vuajtjes, as ndryshimin tuaj.
E ne si përditë jemi të dehurit dhe të nemurit e kohës,
si përditë të plagosur jemi, e në ndëshkimin e fjalës sonë.
E përditë të dehur duke u tretë si kënga e zogjve lart qiellit,
ne që bartim gurë të moçëm e të rëndë, të heshtur të fjalës,
ne që bartim kohërat bashkë dhe të gjithat i vëmë në një thirrje.
Ne që kurorën e heshtjes e kemi si varrin tonë, si qelqi ynë i
pijes,

si vetë vdekja jonë e përditshme në sytë e jetës, e në gjethin e kohës.
Aty ku dashuria është përherë në blerim,
aty nën flamurin tonë të rreckosur, në dritën fitimtare të fjalës,
të kohërave tona të ardhme, të vetë njeriut të denjë,
ku fjala ndriçon në shkimin tuaj, mbi verbërinë e mbi retë e muzgjeve.
E ne po dehemi pa u kujtuar për asgjë,
vetëm për dashurinë kujtimi ynë deri në amshim
e një gjethe po e lëmë dëshmi të jetës bashkë me fjalën.
Si sot e përditë buzëve të çara rrjedh fjala e kohës,
e ajo e përhumbur heshtjes si nën pluhurin e harrimit,
vuajtjeve tona të përsëritura, përbuzjeve, goditjeve.
E dritaret tona janë me njolla, të çara në fyerje të mbrëmjes,
Janë si retë e qiellit, si vetë rëndesa e ecjes në mëngjese.
E një erë e re do e heqë pluhurin mbi gur,
do t'i ndriçojë një ditë ngjyrat e fjalëve të kohës e të heshtjes,
e gjethi ynë do të ketë blerimin e syve te qiellit.
E flamuri ynë do të jetë si pranë gotës sonë,
si pranë varrit tonë që pikon prej qelqi
si fruti i jetës, si guximi i fjalës ku ndrit në errësim
mu si ne kur digjemi në dritën e lirisë e në bekim të fjalës.
Fjala e tij heshti në mesin e bohemëve të tjerë të lënduar,
e të zhytur në dhimbje si në flakën e zjarrit,
e bohemi në bufenë e lagjes po tretej në dehjen e tij,
si në pijen e freskët të birrës.

QYTETI PA SY

A ka sy qyteti dritaret kur i hap,
vesh a ka qyteti, veshët ku i mban?

Gojë a ka qyteti e fjala ç`emër ka ?
Kokë a ka qyteti, udhët ku i ka ?

Kopshtin dhe mëngjesin, vesën ku e mban?
Mbrëmje a ka qyteti, mbrëmjen ku e var?

Mëngjesi është pa sy, matanë perdeve gri
veshët i ka të shurdhët në gershetat lidhë

Gojën në vetmi, në heshtje duke u tretë
brigjeve ka gurë, faqeve janë shtrirë.

Kulmin në rrebeshe e kokën n`emergjencë
udhët s`kanë një dritë, as fillim, as fund.

Ku fillon kopshti e streha n`diagonale
n`horizontale të përthyer, n`vertikale të çalë,

Mbrëmja dhe mëngjesi, janë si perde gri
pa gojë është e pa sy, plot ëndrra në dëshirë

Mbledhur grushta-grushta nëpër kopshte shtrirë
Shenja në të gjelbër, shenja në blerim.

Vertikale e zymtë në jehonë e ngrirë.

Si degë është pa gjethe, qyteti ynë pa sy
si brigje te zhveshura - gurë varresh ne stinë

Te gurët në varre atje në lëndinë
një prag i jetës, një është në amshim.

N`qytetin e verbër, në udhët pa sy,
si degëve të vjeshtes, kur dënes vetmi

E një zog i qiellit është në sytë e erës
e një sy i ëndrrës në ngjyrën e blertë është në çdo fëmijë

VJESHTA

Moj e bukur, moj e mirë
si e more vjeshtën ti
krejt i more fryt më fryt
e i mblodhe një nga një
Një nga një në t`artat ngjyra
në shportë i vure bashkë të gjitha
sikur era që i merr gjethet e verdha
fluturojnë larg diku, si ndër lugje, si ndër fusha
Dhe s'i sjell me kurrë era, ato i çel vetëm pranvera
ato çelin sythe-sythe e në sythe në kurorë
Moj e bukur si lule
në gjoksin tënd ka fruta t`mira
në prehërin tënd je si vetë shporta
erëmira ngjyre dëlira, faqendritura e lëkurëbuta
Duart tua të praruara mbledhnin fruta, mbushnin shportat
e gjoksi yt sa vjen e rritet, edhe piqet, si ne prehër t`gjumit ndizet
duart e tua si degë t`kopshtit, fruta mbajnë, fruta këpusin
gjoksi yt mirë i mban, si dy drita, si dy sythe, si dy lulejetëmira
Vjeshtë në kopsht, vjeshtë në natyrë, vjeshtë te ti është moj e mirë.

AI QE DHIMBJA

Din Mehmetit

Dhimbja e jetës e fjalës
brenga rinore si bregore,
si hone në mes të haresë
lëndimi i një çasti të një
mbrëmjeje të vonë
në tingullin e errësirës,
të errët si nata
e trishtë deri në vrragat
e lindjes të ditës së re.
Ai dhe zogu shpëtimtar,
sqepi dhe kënga e qiellit,
ai dhe syri i blerimit,
toka dhe vetë zemra e reve.
Ai dhe lumi me dallgët,
ai dhe simfonia e mbrëmjes
e natës, e mëngjesit.
Ai dhe fushat dhe kodrat e
qiellit të kaltër.
Ai dhe Arbëria lindur në një fat,
si toka nëpër mallkimin e shekujve,
si koha që po vinte në cicërima zogjsh,
ngadalë, me dhimbje dhe me lule të kuqe.

Ashtu si dhimbja e tij, në ashtin e lashtë,
si jehona sipër oxhakut dhe zogu i qiellit.
Dhe në tufa lulesh u shtri përjetë,
si petaleve në valët e lumit,
si Sizifi me një gur të rëndë
si një vesë që pikon jetë,
dhe një petale plot pikëllim.
Është me shumë se dritë, amshim e kujtim

14 Nëntor 2010

PËRPRAGU

E shikoj dritën e yllit
para mëngjesit
E në mëngjes vesen
që pikon në gjethin e kopshtit
si gjurmë e natës
në rreze qelqi të agut
Dhe dita përshkohet pa fund
si lartë qiellit
si fusha e gjerë në sy të vjeshtës
E në vigun e syve palos retë
në ditën me mot të mirë e me diell
E pasdite atje te bregu
shkelqimi i diellit lë gjurmën e mbrëmjes

KËMBANA E FJALËS

E vetme si një sy, te balli n`obelisk
sipër mes qytetit, lartë si një orë,
si tingull i qetë herë si përmendore
aty sipër varrit,
herë si këmbanë e heshtur
pa zë është në pikëllim.
Është vet varri i kohës,
ështe vet gurë i varrit
në akrep të orës qëndron
zog i kohës
Është këmbanë e fjalës
është goditje e heshtjes,
është vet zë i saj
në fërshfërinë e erës
Hije e zogut është si në pupla qielli,
si në zë të kohës, e në dritë të syrit.
Sipër n`obelisk si n`akrepat t`orës ,
n`cicërimë të kohës ku udhët fillojnë
ku udhët s`perëndojnë
Është këmbanë e fjalës, është goditje e heshtur
është akrep i orës,është në zë të erës
është në sy të kaltër,
është në këngë të kohës është jehonë e orës.

SHEGA NË KURORË

N`shtat të bukurisë
si valëz deti je
mori lule-shegë
mori lule-mirë

N`yllin e qiellit
shtati yt u rritë,
ftyra jote ndritë,
fruti yt u lidhë,
ylli yt u ngjizë.

Fruti yte u rritë
fryti yt u poq
shportën e kërkon,
mori lule-shega,
ti që na erëzon

Fytyra të gezon,
fryti të erëzon
si valëzë nën lule
që s`mbaron dot
as për një motmot

Sa e qeshur je

shega faqe kuqe
shega mori lule
ti që ndritëson
ti që s`perëndon

Në gëzimin tonë
qëndron si përhera
Mori je si drita
mori je si jeta

Fruti yt ti je
e ngjizur në yll je
e bekuar je
mori lule-shega

SELVIA

Një vij ish te bregu
Një vij ish te qielli
Një shkrepje vetëtime
Një dritë pas murmurime

Te Selvia binte
Te ajo vija linte
Te e blerta humbiste

Selvia trupgjatë
Selvia truphollë
Selvia gjethonte
Selvia bleronte

Në trupin e saj
Ishin tri vija
Njëra e blertë
Njëra bojë qielli
Një vijë vetëtime
ndriste ne mes

Në gjethet e saj
vesë pikonte qielli
ish pikëllim i saj

në ngjyrën e blertë
vetëtima ndriste
shkëlqente si përqiell

kur i ndante retë
pikonte sikur vesë
si vija ish në breg
si vija ish në qiell
si vesa ish në gjeth

Në trupin e saj
Në ngjyrën e saj
Në pikellim të saj

Pikon loti i saj
Pikon dritë e saj
Pikon mall i saj
Pikon fjalë e saj

LULESHEGA

Luleshegë, moj luleshegë,
kurora jote çelur si përherë

Në fusha të gjera e këtu te dera
vjen si era, me buzë të qeshura

E në sy plot dritë si behari çel
si mëngjesi ndrit, në blerim si sytë

Frutin e ke lidhë, moj luleshegë
në ëndrrën e yllit që vjen si ngaherë

Kur na çel ti lule, kur na vjen pranvera
ai të pret te dera, te kurora jote, kur çelë si përhera

E ti më je si një e butë pëlhurë
si valët e detit që s`mbarojnë kurrë

Je si era, si puhizë e mbrëmjes,
nën yje të qiellit, syri të ka nxënë

ti je si përhera valëzon si hënë,
syri të praron si valëza në valë

Moj shegë e mirë, moj shegë e dëlirë
në kurorë ti ndritë n`yllin e jetësisë.

E MIRA MOJ

E mira moj, lule moj,
ke çelur oj, pranverë është moj.
Kush të mbolli oj, kush të rriti moj?

N`kopësht të dashurisë,
për sy të djalërisë.
E mira oj, ti lule moj.

Syri i djalit oj, kur të pa moj,
Si një kumbull oj, kurora jote moj,
ngjyra jote oj, trëndafile moj.

Shikonte për dhe oj,
gjelbërimin e barit moj.
E mirë oj, lule moj.

Petalet e tua oj,
Shtrirë qiellit moj,
Pranverë e bukur oj, lule moj.

PIKON NË VESË

Pikoj njëherë
jetë në ndjenjë.
Ajo u tret si në vesë,
pikonte dhe shkëlqente si sytë.
Ndjenja i rrëshqiste në shikim,
bleronte si ëndrra, si natyra,
në krahët e qiellit të kaltër.
Në këngën e zemrës, në gjethin e erës,
si pema në kopësht, si ngjyrat e stinës
Pikon dashuria, përditë si mëngjesi,
në vesë të bardhë, në udhë, në kopësht,
në lule, në dëshirë.
Si pika e ullirit, si vera e hardhisë
prej ngjyrës në ngjyrë n`dritë, n`dritë
krejt dashuri, krejt kaltërsi.
Blerim nën zjarr e tym mbi re
dhe yjet e natës i var në hark.
Si farkëtari u jep shkëlqim,
në vesën e jetës i shkrin i ndrit,
I ndrit, i shkrin, përsëri,
në kaltërsi e në blerim.

ATY KU MIZA BREN HEKUR

Mall i mallit,
dryshk i zemrës.
Shumë herë
ma i hekurt se hekuri.
Disa herë ma dryshk
se dryshku.
Sa tri bota bashkë,
s`rëndojnë më shumë
se malli i saj.
Nuk e zë vendi vend,
i pavend.
ku të shkojë, në askundvend.
O, dryshk i dryshkut,
n`dryshk të kohës,
mall i saj.

Qershor, 2007

VEÇ NJË ÇAST

Ishte gjithçka një fillim
Çasti i fillimit të përjetësive
si rastësisë rrjedha e ujit
në gurishtet e malit
në shtratin e drurit
lugjeve të blerimit dhe erërat
në shtytjen pa formë
ngjyrat si prej erërave përbëheshin
në dritën e jetës
si nga hiçi asgjëja qiellore e nga pluhuri
prej dashurisë morën formëm morën përmbajtje
e qenia ndjeu hapin, lëshoi tingullin
në gurin kumbues vesa e parë e jetës
dhe varri i kohës
dashuria ndriste në themele, në rrënjë
pikëllimit rridhte fjala, vaji ngjyra e qenies
dhe hapat e gjurmëve të rrjedhës
ku fshihej zjarri në driten e përmasës
dhe nga yjet si hark ngjyrat e qiellit
i puthnin brigjet
dhe qeshja e njeriut në fytyrë
në tokën që mugullonte gjithçka nga brishtësia
uji si dashuria nëpër gurë zbriste
në shtratin e drurit të përjetësisë se blertë

e zogu hënor me flatra të arta përshkonte erën
në vija të dritës, në yjet e natës e në varrin e jetës
Në honin e hënës ngjyrat e qiellit puthnin brigjet.

PËR NË PËRSOSJE

Njëherë ishim të përsosur
në fjalën hënore të Lirisë
të yllit e dritës se diellit n`shkëlqim
Njëherë moti ishte dashuria si buka e plotë
e pjekur në prush të shekujve
dhe nëpër hirin e moteve të lashta
Njeriu, Liria dhe hija e tij hënore
Në një kohë të mallkuar ishte çasti i rrënimit
dhe perandori i barbarëve atë çast erdhi
Dhe njeriu ynë e humbi kuptimin e jetës së lirë
ne dhe liria u plagosem barbarisht
dhe shkëlqimi u zbeh në kodrat tona
e që atëherë u bëmë serioz
fisnikërinë e ruajtëm bashkë me ëmblemën
përgjumjen e fshehëm nën kujtesën e lashtë
se pushtimi ishte i gjate dhe ritet tona ishin njerëzore
dhe lumi ynë ecte në degëzime
dhe dashuria s`humbi kurrë si vetë drita si dielli i jetës
dhe lumenjtë u pagëzuan në fatin tonë
sepse ishim të një moshe me gjithë natyrën
dhe të shtrenjtë e kishim shkabën dykrerëshe
tej miteve ishim dhe asgjë prej nesh s'po perëndonte
vetëm liria s' ishte si dikur
nëpër errësirë e bartëm ne ashtin tonë

e në asht ishte lumi dhe dashuria
fati dhe mosvdekja jonë
e lirinë e kishim në honin e bardhë të zemrës
dhe u dashuruam në të përgjithmonë
mbi të gjitha vdekjet, mbi të gjitha humbjet
dhe perandorët e barbarëve s'janë më në kohën e tyre
dhe s`janë më kurrë perandorë si dikur
dhe ne dhe shkaba e përjetshme
Liria jonë ishte plisi, ishte burimi,
ishte qenja hënore e shkabës
ishim të gjithë një eshkë si kandili,
mbi perandorët e vdekur
mbi errësirën, mbi frikën e vdekjes dhe mbi mitet e kohës
Gjergjin e kishim t`rilindur në Mesjetë si sot në kalërim të shekujve
dhe ardhmëritë tona të pasosura si dashuria e jetës,
Atdheu dhe drita mbi eshkën tonë si kandili i Lirisë, drejt përsosjes.

DRITARJA

Asaj dite ajo ishte ndryshe
si pëftim i një drite të qiellit
para syve ishte si shiu i mbrëmjes
e pas shiut si harku që lidh dy brigjet.
Dritarja ndryshe ishte asaj dite
Si s'kishte qenë kurrë më parë
Gjithçka sikur ndriste
Prej asaj dite ajo ishte gjithçka
as ballkonet, as shtëpitë, as lagjia më s'ishte si ajo
as një ngjyrë e qiellit s'ishte më në fuqinë e zemrës
E në sytë tanë dritares e shihnim fytyrën e saj

LULJA E VERËS

Lulja e verës
është stina e diellit,
kohë e pushimeve.
Hareshëm buzëqesh
Atdheu,
si dielli në tokën e mirë
të ngrohtë.
Në gjelbrimin e barit
shiu i imët,
në dashurinë e lules së verës.
Mirësi e erërave
ngjyrë e butë, e mirë
e freskët si mbrëmja,
e purpurt si dita e ngrohtë.
Pranë detit në ngjyrën e ujit
Lulja e verës,
Si ne gurin e kripës, erërat dhe pikëllimi,
si pishat në tokën e thatë,
në ngjyrën e vjetër,
në lashtësinë e kohës.
Në stinën e bregut të diellit,
n`etje të zhytura janë
në krahët e kripës së heshtur.

E kaltër është pasqyra e valëve
si brigjet e reve të qiellit.

VJESHTA

Vjeshta verdhushe,
stinë e pjekurisë.
Ku mblidhen të lashtat,
dhe frutat erëmira.
Ca radhiten në shporta,
e ca pikojnë si vesa.
E pemët i lë të zhveshura
era i merr me vete
duke i tretë një nga një
gjethet e verdha

II
Ngryset nata
dhe vjen mëngjesi,
ngryset dëshpërimi,
vrapon gezimi,
pas një vdekjeje
vjen një jetë,
shkon një stinë
e tjetra vjen,
shkon e vjen
e vjen e shkon
stinë më stinë
e vit për vit...

ikim ne
të tjerët vijnë
çdo mëngjes
është një gëzim
e çdo mbrëmje
lind një shpresë
për ditë të re
me hare.

NË TINGULLIN E KITARËS

Si një pikë e shiut kur pikon prej qiellit
dy tinguj në dy pika të tjera uji
tre tinguj ishin, një ritëm i shiut të mbrëmjes
më pas pikat shtoheshin njësoj dhe rrëmbyeshëm
Përmes ritmit si drita në vetëtima të erës
në bubullimat e shiut të imët kur e humbnin tingullin
e mbrëmja merrte zjarre si në zemrën prej mëndafshi të mirë
në këngën që fluturonte si qetësia pas shiut
Kitara si vetëtimë e tingujve, në ritëm, t`harmonishëm
nën strehën e kulmit s`po ndihej më rëmbimthi furia e erës as e shiut
partitura në melodi në lojën e ritmit
Një krijim në ndjenjë si natyra e dashurisë
në një çast të përjetimit të këngës së mbrëmjes
në shpirtin e saj të virgjër, ku treteshin tingujt në zgjim vetëtimë
e më pas kur qielli merrte trajtën e përsosjes së heshtur
E kitara në telat e saj, n`melodi ndritësonte hareshëm sytë e mbrëmjes
si në fluturim zogjsh, tingujt dhe zemra në sytë e saj
ishin vetëm shenja të një kënge të vetme,
në çastin e një mbrëmjeje që kurrë më s`perëndoi.

PËR TY MIMOZA

(Mimoza A...., poetes dhe shkrimtares së mirë)

Për ty poete Mimoza
si një lule e rrallë në shkëlqim
që çel në dimër.
E vera e brishtë, e mundimshme,
e revoltuar qytetin e zgjon,
shumë para agimit të ftohtë.
Halucinante s`duhej të ishe.
Ti grua e kohës që herr mjegullën.
E tymit mbytës të kafenesë ia hap dritaren.
Aty ku mikun e shikon vërtet në sy.
E kur fillon të përhumbesh kujtimeve,
të përëndërrta,si petaleve të lulemimozës,
udhëtimi yt.
Aty ku gota me verë harrohet në kafenenë e qytetit pa emër.
Aty diku në Tiranë a në Vjenë,
apo në qytetin e hardhive të Ilirisë.
Ku ta dimë!
Halucinante s`duhej të ishe.
E ftohtë si lulja e dimrit, në përhirtjen e hershme,
revolta dhe brishtësia në zërin thirrës.
Stinëve të vitit dhe vera e plogështive të tua.
Në ngjyrë të fjalës, si në margaritën e bardhë.

E ti Mimozë e zgjon qytetin herët,
shumë më herët se agimi i ftohtë.
Pse halucinante s`duhej të ishe,
as ecjeve rreth Lanës, e sheshit të qytetit,
as në rrugët e shumta.
Ti, drejtuese e varkës sipër shtërngatash,
si mjellma e liqeneve të hijeve të natës.
E kënga nëpër tingujt e kitarës, e ka ngjyrën e dhimbjes sate.

NJË NATË E GJATË

Më the të prisja në bregun e diellit
ishte mbrëmje e vonë pa hënë
gjethet luhateshin lehtë-lehtë në erë
pritja e gjatë si një shekull i rëndë

Edhe ti ndoshta prisje në rrugën tjetër
në shekullin tënd të natës pa fund e të verbër
të dytë mbase s‘e shihnim pikëtakimin
unë këtej rruge e ti pak më tej, në anën tjetër

Ne nuk u pamë aty atë natë,
as hëna nuk doli në qiell
yjet atje lart s’i shihnim dot
e frynte një erë e një nate me terr

Gjethet ishin si vera e etur
sipër drita e hënës, në pritjen tonë
e në mes rrugëve në natën e verbër
ishte dashuria,
po ne s`mund të shiheshim atë natë

NË KOPËSHT

Kam vizituar
shumë kohë më parë,
një kopësht drunjësh
krejt të thatë.
Nëpër degë,
kishte shumë gjuhë,
në fjalët e tyre rrinin varë,
luhateshin si nëpër litarë.
E bredha kishte shpatit aty pranë,
ku s'kishte as barë,
hone etjesh ishin e zhyteshin dalëngadalë!

PËRDITË

Ne përditë
vijmë në moshë,
e kohën çast më çast
e lëmë pas.
Ajo ik trokon me vrap,
si kandil i ndezur n`erë.
Është kujtim, e na vjen pas,
flakë e tij e zbehur ndrit,
ditë përditë,
atje lart, thellë në erë.
Lart e thellë atje në qiell,
si gjethi t'u u tretë,
n'krahë të lehtë, në ngjyrë të vet.

NË KOPSHTIN TËND

Në kopshtin tënd ka lule plot
zgjatma dorën oj, ma jep një lule moj.

Në kopshtin tënd pemë me fruta plot,
zgjatma dorën oj, ma jep një mollë moj.

Në kopshtin tënd, ka kumbulla shumë,
zgjatma dorën oj, ma jep një kumbull moj.

Në kopshtin tënd, oh sa shumë ka ftoj,
zgjatma dorën oj, ma jep një ftua moj.

II
Pse të jap një lule, pse të jap një mollë,
eja ti këputi, preki vetë me dorë.
Pse të jap një kumbull, pse të jap një ftua,
eja vetë afrohu, preki ti me duar.

III
Unë do të vij e do të të rrëmbej,
zgjatma dorën moj, pakëz më ndihmo,

ma largo këtë ferrë, të t`afrohem moj.

E në kopshtin tënd ne do të këndojmë,
këngën e kurorës, kurorë e mollës moj.

TË PRISJA

Në qytetin e zambakëve,
me rrugë të vjetra, sa vetë kohë e tij.
me gurë të vegjël, të ndritshëm si xixa farkëtari,
nën hapat e ecjeve,ndihet melodi, si nëpër tinguj të rinj.

Unë të prisja Lira ditën e hënë
në mbrëmje te ura.
E ti nuk ishe.

Të prisja të martën, te krojet mes sheshit,
e yjet e mbrëmjes ishin të ftohtë.
as aty nuk ishe.

Të prisja t`mërkurën te dera e kështjellës
sokakut se shihja as hijen tënde,
nëpër erën e mbrëmjes shushurimë zogjsh
vetmitarë dëgjoja.

Të prisja të enjten te shtëpia e vjetër,
shëtitores ecnin njerëz pa fund,
e zëri yt s`ndihej, përveç gurgullimit t`ujit
grykës së malit se si rridhte.

Të prisja të premten aty pranë kinemasë,

nën dritën e neonëve, shikim i verbër.
E ty s`të shihja më askund.

Të shtunën të prisja, atje te teatri,
ishte natë e gjatë që s`mbaronte kurrë.
I shikoja ballkonet me lule, nën qiellin e ftohtë,
As aty, Lira ti nuk ishe.

Ah, ditën e diel unë s`të prita më,
një ditë krejt e purpurt,nën shpresat e vrara.
Në kafenenë e vjetër të qytetit tonë,
atje thellë strukur në qoshe rrija,
si një dashnor i përhumbur n`mendime.

Dhe pija verë të vjetër prej rrushit të kodrave tona
në kujtimin tënd sa shumë gota zbrazja.
Tërë lulet e botës do t'i lija,edhe për njëherë të vetme,
ashtu si në atë pamjen e dikurshme të të shihja.

Të prisja përherë kudo, në qytet,
e ti askund asnjëherë nuk ishe.
Lulet në ballkone më si shikoja,
se në pamjen tënde, asnjëra më s`ngjante.

E DASHUR

E dashur,
tërë natën ke fjetur e qetë, e heshtur.
Pamja jote e verdhë, e zbehtë dhe duart e ftohta.
Kaq hijerëndë më je,
kurrë s`të kisha menduar më parë,
kështu në gjumin tënd të përjetëshëm.
Si pemë e vyshkur.
Pamja jote dëshmi e jetës,
Kujtimi yt i ftohtë, ashtu i heshtur rri,
si nën zjarrin e shuar pamja jote e hirtë.
E ti fle e shtrirë kujtimit të humbur,
si në ëndrrën e paramëngjesit
e mpirë të moskthimit,
e ngrirë, e shtrirë e zbehtë.
E dëshirat nën fytyrën e verdhë, rrijnë të fshehura,
të një kohe tashmë të fikur.
Tani malli im udhëton si varg i zgjatur pas teje.
E kopshti ynë është boshatisur,
përherë do të ma thotë ikja jote.
Atje ku do tretësh ngadalë-ngadalë në pëlhurën e gjumit,
e unë në kujtime shpalos pamjen tënde.
Ti një natë të errët, ishe ngjizur në jetë.
Dhe kështu po në këtë natë të njëjtë si atëherë,
në shtrat, në dhomë pushove përgjithmonë.

E në mëngjesin e ri, ti s`do të jesh më.
në vendin ku uleshe, rri kohë e së djeshmes
aty ku sytë e tu morën pamjen e varrit
si perdja e grisur e pasqyrës.

HIJA E ZOGUT

Pranë burimit
shelgu
në tri kurora
sipër ujit hija e tij e freskët
Puplat zogu
i ka lënë shenjë
në ngjyrë të ujit
kur çastit të tij fluturoi
stinës së përjetshme
E zërin e ka
në fërshfërimën e erës
melodi e përsosur është
e fushës e malit
E në shkëmb
ca pika të plagës
gjurmët e tij
në ngjyrë të fluturimit
të lartësisë qiellore
I kaltër është si uji i burimit që rrjedh
shtratit të hijes së tij të purpurt
nëpër freskinë e erës
të tri kurorave të shelgut.

TRINITETI YNË KOMBËTAR

TRINITETI YNË KOMBËTAR

I gjithë shqiptarëve, i gjithë brezave,
që kaluan dhe mbijetuan në shekuj.-

Në emër të
Atdheut tonë të shenjtë
Gjuhës sonë të artë e të bukur shqipe
flamurit tonë të përjetshëm të Gjergj Kastriotit
Pastë Bekimin dhe Uratën Kombi ynë i mirë dhe fisnik për gjithë jetën!
Amen!

40.

Ne e sotmja

S`mund të jemi e djeshmja
s`mund të jemi e nesërmja
ne jemi e sotmja e përditshme

fillimi i jetës, e sotmja
në të sotmen lindja
jetojmë të sotmen
në të sotmen është

vetë vdekja

Ne s`jemi dje as nesër
jemi sot
e tashmja e përhershme
jeta dhe vdekja e tashme
s‘ka kohë tjetër
as dje, as nesër
kujtimi është i së sotmes
për atë që ishte e sotme
ëndrra është për atë që duhet të jetë
në të sotmen e tanishme...

AI

Ai, i dehur, zhgënjimit të tij i fliste
thoshte dehje edhe sytë i kishim
tani përhumbjes rrëshqasim
për të dikurshmen fliste
pa pushim, krejt i lodhur
i vishej fytyrës së tij një gëzim
i lehtë i etërve
si pelhurë e ëmbël e ngrohtë
e më pas zbehej në të ftohtë
herë-herë si vetëtima vezullimi
i vinin prej shikimeve të tij
si para bubullimës që duket e humbur
fshihen nën qepalla të thella
ashtu ai ecte ngadalë i lodhur
belbëzonte fjalë ndër dhëmbë
duke ecur këmbë më këmbë rrugës së gjatë
fliste me mirësi udhës duke u tretë
si qiriri i kuq i tëri dukej
si vetë zemra e tij ngjyrë e kuqe
shpirti i tij i bardhë si drita e jetës
si flakë n`fitil digjej përditë
e shkrihej nën zjarrin e tij, qiririt të kuq i papërmbajtur
si shirit erës i linte pas shenjat e jetës në stinën e tretë
në pëlhurën e grisur me ngjyrën e hirit

si nën ngjyrën e zjarrit të heshtur
aurorës së saj të stinës së zbehtë
e shikimi i tij shëmbëlleu duke u tretë
për herën e fundit
në ngjyrën e lules margaritë
në kurorën e saj përhumbur
I la gjurmët e tij si në gjethet e verdha të erës

HERËN E FUNDIT...

Herën e fundit
fqiun tim të plakur e pashë kur ishte
i ulur në stol para ballkonit
aty në kopësht të pemëve pa fruta
pranë shëtitores së gjatë të ngushtë

Ulur dridhej i tëri dhe mbahej
në shkopin e tij të drurit
ishte mëngjes dhe plot gjethe të verdha
të rëna në stol te këmbët e tij e rreth e rrotull
e gjelbërta s'ishte më, as aromë e frutave s`ndihej

E ai fliste ngapak, ngadalë, fjalët e tij të rralla
lëkura e ti si nur fytyrës me rrudha
me plot grimca kohe të së shkuarës
kujtimet e tij si valë rridhnin
pamjes së lodhshme si një gëzim fëmije

Të holla sa vinin shpresat e shkonin humbur shikimeve
në sytë e tij të shterur si guva të thella
e mjegulla e mëngjesit ishte pa dritë
në buzët e paradimrit ai dridhej si gjethi
nën mjegullën e mugët me pamje hiri

I lageshin flokët e pakta të bardha,
lot qerpikësh fshinte dhe fërkonte duart

Ai filloi të ecte më pas rrugës së ngushtë
ngadalë i kërrusur mundimshëm
i vetëm ishte si nëpër mjegull i humbur

atje për te kopshti i vyshkur i qytetit
ku shkonte për çdo javë
prej nga s'u kthye më kurrë

Pas tri ditëve kuptuam përmes gazetës
atje ai tani pushonte i qetë
pa kurorë, pa kujtime, pa lule...

Një jetë e tërë si një hark vetëtime
që vjen nga qielli me vrap, e dritë e tij
shkon duke humbur, duke u shuar në thellësi të tokës.

***

(Ajo ishte dita kur filluam ta mësojmë kuptimin e vërtetë të errësirës)

LULE DHE ZOGJ

Lulet e majit, kurora ndër stinë
me ngjyrën e kuqe,
në shenja kohe janë,
te koka e heronjve,
dëshmorëve e martirëve,
përulen sipër tyre
dhe i kujtojnë me mall.
E zogjtë me erën
pranverave kur vijnë,
ndalen aty pranë
dhe u thonë ca fjalë
me dhimbje për ta,
rrezet e mëngjeseve
te ju, te ju janë.
E ca të tjerë vallen
hedhin nëpër re,
te ju s'ka dimër thonë,
te ju ka veç pranverë.
Në vjeshtë zogjtë largohen,
kujtimin e lënë në erë,
për ta si një shenjë.
E lulet aty treten afër
të rënëve pranë e pranë,
në stinën me vjeshtë.

Për të çel përherë,
në prill e në maj.
Kur dhe zogjtë kthehen
me këngët e tyre,
me shumë mall
n`kujtimin për ta përsëri

UDHËTARI

Udhëton i vetëm nën yjet e natës
shtigjeve në fusha dhe në brigje
te lumi herë-herë vetmitar i këngës
si te liqeni me cicërima zogjsh
në puhinë e erës si gjetheve të verës
Udhëtar i vetëm si vesa në tingullin e mëngjesit
në krejt kujtimet bashkë në një dritë
si hëna në fanar brigjesh e dete
si fiku në kopshtin e vetëm
si kurora e mollës pranë lulepjeshkës
si në vijë të dritës në harkun e qiellit
nëpër retë e zymta ku shtrihen si nën prarim të diellit

MBRËMJA ME TY

Si vetë gëzimi ynë
i paharruar dhe i bukur
natë e ëndjes për në mbamendje
si nata nën dritën e kandilit
të dytë ishim në harenë e takimit
në fjalën tonë të heshtur
në zërin hyjnor në rrahje zemrash
dhe buzët tona vdisnin në harrim
si kandili errësirës në mbrëmje
me dritë të heshtur përgjithnjë
si në heshtje dhe ndjenja e fjalës
E njëri-tjetrin e plotësonim të dytë
unë dhe e dashura si vesa qiellore
harmonishëm si hëna e plotë
lëkura si qumështi në zjarrin e hovshëm
si qelqi të ishe e tëra kujtim
e përflakur në dëshirën e takimit
e mbrëmjes i dhamë çastin e harrimit
U zgjuam dhe vdiqëm sa herë në njëri-tjetrin
dhe lamë pas gjithçka nga jeta
dhe hapëm në mbrëmje shtigje zgjimi
udhës tonë ta bartim njëri-tjetrin
sikur bekimin mbi mallkim
me dashurinë e pafundme

me kandilin e varur si hëna errësirës
E dritarja jonë po merrte formë
afshit të natës si pema e jetës
e tej xhamave ishte natë
dhe vetëm ne dritësonim nën kandil
të heshtur deri në dhimbje, fjala dhe gëzimi ynë
hareja në tik-takun e zemrave të lumtura
dhe shikimi ynë si vdektarët e heshtur
Edhe nata e heshtur ngadalë po rrëshqet
dhe dita po lind në majën e malit
e te kurorë e fikut po zbret rrezja e parë
dhe xhamat e dritares po i puth shkëlqimi i saj

PRISHTINA

qytet i shtrirë kodrinash
thellësi motesh të largëta
t`qytetit e kulteve nën rrënoja
shenja kohe, gjurmësh të vjetra,
pluhur e pëlhurtë në kujtesën e saj.
I zgjimeve të reja nëpër ditët që vijnë,
sikur shiu që pikon në kohën e vet,
pellgje të vogla
pranë luleve i ujit,
e blirëve u jep jetë.
Dhe kohën stolis me gjeth të gjelbër
me shiun e stinës,
blerim shprese n`aurorë të artë,
për të nesërmet që nuk perëndojnë.
Me ëndrrat e kohës, këngë e saj,
kujtim i pashlyer në dashuri të pafund.
Në udhën e blirëve kujtimi i lirisë,
n`shenja të skalitur me vitet e shkuara
përpjekje e parreshtur udhës fisnike.
Prishtina e të rënëve n`flamur të jetës,
n`kuptim të dinjitetshëm të shpresave rinore.
Për n`agimet e mëngjeseve prore.

TI ZOG HYJNOR

Ti je si lule
fryt i saj
i veshur
me petale
trëndafili
në hapësira të jetëve,
që kur filloi
koha të rrjedhë.
I lashtë sa vetë toka,
lindja jote
e frymës qiellore
me ngjyrë
t`lule bozhurit.
Prej aty fluturon,
hapësirave të gjera
lartësive qiellore
atje sipër maleve,
mbi shkëmbinj të lartë
si kurorë e qiellit,
është pamja jote,
me krahët e tu
pushtuese e pafund
në frymë shenjtërie
e të gjitha moteve.

Ti Shkabë hyjnore
u bekove
në altarin e pavdekësisë,
ndër kohëra të rënda,
tragjike,
mes dhimbjesh,
dhe nëpër fitore.
Ti barte me vete,
vetë përjetësinë
qenien e jetës
të amshuar,
e dritën e saj,
n`pamje t`hyjnisë.
Ti zogu ynë,
dy krerësh
hyjnor i qiellit dhe tokës,
emblemë,
e praruar
n`eshkën tonë
të pafikur.
N`kujtimin sublim të lirisë.

DORËSHKRIM I VITEVE

NATË ME HËNË

Në këtë natë të qetë, pa zhurmë
hëna me pamje të purpurt bën dritë
sipër saj në qiellin e largët mugëtirë
sa e sa yje të shumtë duken të qeshur, xixëllojnë.

E këtu se si duket natë e ftohtë
me pamje dritëzë-hëne e me hije plot
një kujtim i vjetër shfaqej tej dritares në kopësht.
Kur lulet pastroja nga bari i egër,
e të lira shtriheshin në erë
pranë kumbullës, dardhës e mollës,
dukeshin e ndjeheshin në pamje të artë si pamje prej ftonjsh,
kur dorën zgjatja të merrja një frut
prej një degëze të pemës në kopësht,
se si ndjeja, sikur në ëndërr, sa afër, sa pranë,
gërshetin, si një shall me ngjyra, e pamjen e saj.

Hijet e thyera kopshtit shtrirë vështroja
ecja sipër tyre si në përrallë,
me kujtimin e bukur pranë frutave,mall i saj
në dritën e qetë, këtë natë të freskët me hënë.

TI MOJ LULEMIMOZË

Këtë pamje të ndritshme,
të paparë kurrë,
si në këtë stinë hënore
të përjetshme t`shpirtit,
në kujtimin e dëshirat e mia.
Ah, botë e ftohtë e përherë.
Ti lule e mirë me petale mimoze,
ti e kohës tënde je,
sa shtat të hedhur ke,
se si të vura re, në çastin e shenjtë,
e pamja jote m‘u bë,
përftim drite e përjetshme.
Në këtë botë të lëmuar për kastile,
që knaq vetëm sojin e vet.
E të tjerët të nemur deri në vajin e shterur,
si hijena të ftohta dimri në çdo stinë.
Ti që ke çelur në dimër,
me shtatin që ke dimëror,
sa shumë e brishtë je
ti e bukura,
ti moj belkëputura,
moj lulja mimozë.
Si më bëre për vete
për gjithë jetën moj.
Në të gjitha këto fusha të gjera,

ku ishe aty si nën ferrë,
më bëre të të ndjej
dhe e vetme ti, deri në amshim.
Ti vetë je, shpirti moj,
ti vetë je, jeta moj.
Ti moj lulja mimozë,
nga dita që të pashë
s`m'u ndave më, prej sysh.
E në dritaren time,
tani si dukesh ti,
përherë e qeshur
me pamje të hijshme,
t`siluetës së mirë,
si prej shkëlqimit
të purpurt të butë,
të agut të artë,
me pamje prej hëne,
për çdo natë.
E krejt e hollë, si kandil i hollë,
me dritë të amshuar si prej qiriri je,
e tymi yt udhëton,
përshkuar lart qiellit,
atje te yjet mëngjesorë.
E pamja jote,
si hije nën dritëzën e prarueme,
përftuar në fytyrë të përsosur,
përnatë dritares sime.
Oh, ngjyra jote lulemimozë.

DORËSHKRIM I VITIT 2006

GRUA

Për ty sot, Grua.
Kujtojmë Hyjneshën në fron,
thellësive të shkuara
të moteve ILIRE!
Për tetë marsin tënd.
Për ditën
tënde,
festojmë,
urojmë për ty sot.
Aty pranë luleve
te vazoja plot
jetë,
në tavolinën e drekës
pranë gotës
me verën e shenjtë,
të ruajtur enkas
për festat, urimet
për dashurinë
dhe besimin
tonë.
Tani grua,
merr gotën, kujto burrin.
Gëzuar dhe zbraze deri në fund
Për festën e jetës së trëndafilit,

pranverë e gjithë qiejve,
e të gjitha moteve,
në ndjenjën tonë,
qëndron ashtu, sikur je,
krejt e praruar.
Me Fjalën,
tri herë gëzuar!
Më pas,
Amen!
Oh, grua!
Se kështu është.
Ndërthurje e përbashkët
e natyrës, e vazhdimësisë
së jetës tonë.
Në këtë botë njerëzore.
Krejt të vetëm jemi.
E të dy ne
jemi plotësimi,
Nën kurorën
e përbashkët të së
bukurës qiellore
që bën dritë
dhe përfton magjishëm
ndër ne për të gjitha motet!
Pranë lules pranverore
e pranë gotës me verë
të ruajtur mirë enkas
për këtë ditë.

Ne jemi festa jote Grua,
aty bashkë jemi ne.
Gëzuar! Jetësisht! Gëzuar!

Mars, 2006

NE NUK JEMI ATA

Ne nuk jemi ata,
ata nuk janë ne
ne jemi ne dhe s'jemi si këta
as si ky tjetri nuk jemi
Jetojmë të gjithë në jetë
të ndryshëm të gjithë nga të gjithë
E ne jemi ne,
unë dhe e dashura ime dy pjesë të munguara
unë që s'mundem pa të
as ajo pa mua
por edhe me të jemi vetja jonë
dhe bashkë e kemi jetën përjetimin në përmasën e saj
Ne jemi buzë humnerash në thepat e jetës
dhe në dritë-hijen e njëri-tjetrit-jemi në hije-dritën tonë

BOTA IME

Bota ime nuk ngjan në botën e asnjërit
As helmi i saj s`është i njëjtë, as hoja e mjaltit
As lindja e botës sime s`i kishte dhimbjet e tjetrit
As lotin e fillimit, as lotin e jetës
As rrezen e vesës sime të parë
Bota ime e ka përmasën e mendjes
Të ëndrrës së pasionit dhe syrit të tejdukshëm
Atje ne skajet e rrathëve të saj dhe syrin e ndjesisë
Dhe më tej hapësirave të gjera dashuria
E dritës, e mendjes e vesës së zemrës
Bota ime jam unë qenia ime e vogël e zhytur thellësive pa fund
Simetria e dashurisë në asimetrinë e shkëlqimit
Të aurorës sipër brerores së ashtit
Dhe unë jam bota ime e përmasës së duarve të jetës
E hapave të mi e të kopshtit të luleve e bimëve
Dhe pemëve e frutave të saj
Dhe bota ime nuk ngjan në asnjë botë të tjerëve
Sepse lindjet janë në vesën e botës së bekuar të dashurisë
Dhe unë e të tjerët jemi botëra pa fund
Të ndryshëm në lindje, në dhimbje, në dashuri dhe në dritë
vetëm dukja është e ngjashme mes nesh dhe rrugëtimi
Si çdo botë njeriu e ka burimin e tij të kroit si qiell i
kaltër
Dhe unë kroin tim që shkëlqen në prarimin e vet

Sikur sytë dhe zemra e të dashurës sime
Përnatë tretem shikimit të saj si në brigje, si në lëkurën hënore
Dhe në dritën tonë të mëngjesit ngjizet një jetë
Dhe lind në një vesë edhe një botë tjetër.

NËN DRITARE

Nën dritare ka lule
pa gjethe
Si hije te holla të varura
nëpër vazo
Në ballkonin prej drurëve
të malit
Dhe drurët e stolisur
me lule
Dhe dritarja e stolisur
është
Drurit në kurora të lulemargaritës
Është buzëdimri
n`erëra të ftohta
Dhe fytyra e saj s'ka më dritë
te dritarja
Dhe xhami i dritares është si retë
e errëta
Është gjurma e tymit t`kandilit
të fikur
Perdja si muzgu i mbrëmjes
së ftohtë
Prej mëndafshi të butë është në shenja
të vetëtimës
E çarë në dysh si dy gërsheta të lidhura në fjongo

në pamje të hirtë
Në profilin e dritares prej druri
të stolisur
Ballkoni dhe lulet si hije thuprash të shtrira
në vazo
Dhe buzëdimri në erëra me lagështi, në retë
si muzgje
Pas dritares brenda ka shenja acari
në qetësi të plotë
Një vetmi e trishtë si gjurma në dritën
e shuar të kandilit
Dhe lulet e stolisura nëpër drurin e kohës
e të ngrira janë në bukurinë
e tyre
Petalet në vija si hije kurorash
të margaritës

E BARDHA

E bardhë ngjyra
si qielli i bardhë me re
E errëta më pas në muzgun
e mbrëmjes
E zeza në natën si korb
e errët
Pa hënë dhe pa yje.
E bardha qesh në shkëlqim
të diellit
në vijën e hollë të natës
e ditës.
E bardha është e lirë në hapësirë
të gjerë
Në muzg dhe në re më pas
e bardha
Si nata, si korbi, pa yje, pa hënë,
pa dritë.
Në gjithçka të errët vjen një e re
e ditës
Përballë saj janë të gjithë fanarët
e kohës
Janë mëngjeset dhe hëna
para shkëlqimit
Asgjëja si valle e hiçit të pafundmë

dhe yjet burim i qenies
Syri ynë i largët tej asgjësë, tej të
errtës
Në brigjet e largëta të reve,
të kohës
Te shkëlqimi i ditës së parë,
e kuqërremtë,
shtrihet mbi natën jeta
dhe brigjet.
Shenjat mbi gjurmët
e bardha,
fanarët e qiellit dhe dita e parë
e tyre
Dhe harku i ngjyrave
të ylberit
Te rrjadha e ujit të
kaltër në valëza shkume
si brigje burimeve të bardha

PORTOKAJTË E VERËS

Vera dhe portokajtë e pjekur
era puhiste te sytë e dashurisë
dhe puhia në tingujt e Lirës
sipër detit të kaltër
te portokajtë ishim të dytë
dhe ishte çasti ynë
në ngjyrën e livores portokalle
u përjetësuam ne dhe jeta
dhe te ulliri nën gjethe
si kurorë ishte ngjyra e blertë
takimi dhe shtegu i udhës sonë
I një çasti që u ndje vetëm njëherë
dhe më s`erdhi kurrë te ne
as dita e artë e çastit
si gjithçka që ishte e përsosur
Dhe kujtimi mbeti te çasti ynë i vetëm për gjithë jetën
atje te portokajtë, te puhia e tingujve të lirës

ATY

ku uji s‘e di fjalën zot
as gjuhën e tij s‘e di
as mëshirën, as shpëtimin s’e sheh.
Aty ku njeriu s`ka asgjë nga lutjet,
ai është i tëri i mërdhirë, i zhytur
në çdo gjë është në vjeshtën e ujit
në drithma të frikshme ku jeta
luhatet në buzët e vdekjes
në lotin e tij, më i rëndë
se vërshimet e vitit.
Aty është njeriu, fëmija
dhe kokën s’e ngre kah qielli
dhe nuk lutet më për mëshirë
duke vdekur
është ngapak në fije shpresash
të mbrëmjes.
Aty ku njeriu është i tëri vetvetja
dhe zoti i shpresës s`duket askund,
dhe nata e trishtë, në syrin e fëmijës
uria zbathja dhe uji, në fuqinë
e dorës së rëndë
aty është kuptimi i dorës tënde,
fuqisë tënde të mbetur
aty te buzëvarri yt

te buzëjeta dhe fytyra e mërdhirë
Pa zot, pa lutje, pa mëshirë
ti njeriu i qytetit të mirë
ti njeriu madhështor i fatit
ti njeriu hero i vetes
Ti qytetar i denjë
shqyeje bishën e mallkimit tënd
me duart e tua
dhe flijoje te dera e vërshimeve
të vjeshtës
dhe vëre nën frikën e vdekjes
nën thembrën e mallkimit të saj
si mburojë e fatit tënd
Aty ku petalet e pranverës
çelin mbi kripën e detit,
aty ti je vetë zoti i malit tënd të rëndë ,
i qiellit tënd të kaltër,
i lumit tënd të jetës dhe pa lutje e pa mëshirë
ashtu si flijimet e tua të largëta,
ku rëndonin në peshën e lotit tënd si tani....

AI DHE GJYSMA E TIJ

Ka oborr para shtëpisë
një kopësht është më tej
shtëpia ka derën e drurit
si relike e vjetër shenjën e diellit
ka yjet
e vjetër relike e lashtë
tri kate në shkallë prej betoni
oxhak dhe korridore,
ballkone atje sipër oborrit
dhe udhët më tej,
dhe pesha e kryqeve
qetësi nate e plotë,
dhe vatra është në dhomën e pritjes
përballë kuzhina
dhe sipër kulmit është gjysmëtymi i vatrës
gjysmë si shtëllunga resh ngjiten lart qiellit
e gjysma tjetër e heshtur dhe kuzhina është gjysmë
e gjithçka në gjysma
gjithçka dhe kudo,
përgjysmë është edhe heshtja
edhe shikimi, edhe zëri, edhe hija
gjysmë në gjysmën e dukshme
Ai, kuzhina, salloni dha vatra
janë gjysma dhe gjysma tjetër është hija e tij

bashkëjetojnë me fjalën, me ditën
dhe natën e kohën
si një gjysmë e përditshme
dhe gjysma tjetër është kujtim
në gjysmën e heshtur si nata,
si vatra, si oxhaku, si dhoma
si gjithçka gjysmë e kohës dhe e heshtura tjetër e pandarë.

I TRETURI

Isha tretur te ti
si në ëndrrën e jetës
si dehja e përjetshme
në shikimin e parë
I tretur si në pëlhurë të syve
te pamja jote si hyjneshë e dritës
Edhe pse kurrë s‘u luta
sepse e dija që lutja s`kishte
as pamjen, as hijen tënde
Gjithçka ishte si nje shkurre moçali
dhe lutja ishte si një vend bretkocash
Dhe ti e praruar ishe si ëndrra
ku u treta përjetë te lëkura jote
si prej mëndafshi
Dhe gjoksi yt dhe dy brigje të buta prej lekure
dhe dy tëmtha të mira si sythe gonxhesh
dy sisat e mbushura gufonin hareshëm
trupit tënd si pemët e dritës
dhe me dëshirë pritnin të pikonin jetë
I tretur në ty ishte bekimi ynë
si mjellma te lumi ku i lënë gjurmët e këngës
te pendlat nëpër barin e egër,
dhe sytë në dy brigjet e kohës
Dhe harrimi për ne ishte i vdekur në ditën e parë

dhe ditën e parë si tani s'u lutëm ne kurrë
Gjithçka ishte e qartë si vdekja
aty vdiqem kur u dehëm të dytë
dhe ti, e dashur, s'u zgjove më
ashtu si unë nga tretja e parë.

NË BRIGJET E HIJEVE

Atje në brigjet e hijeve
është hëna e pasmbrëmjes
është ylli i paramëngjesit
është hija e purpurt e natës
është flaka mbi hijen e qiririt
është gjithçka te nata
është si vdekja e zbehtë në hijen e saj
e zbehtë e egër e mëndafshtë si hija
është burim dritash vetëtimash
natës pa fund, shohim si nën hijet
e dritave të ftohta, brigjeve të errëta
si pirgje të larta gurësh,maje të thepisura
Dhe matanë është vuajtja, dhimbja
dhe loti në mundimet e rënda
të gjumit, të ëndrrës, të yjeve,
matanë një lutje
këndej një mallkim;
matanë një shpresë
këndej një përpjekje dëshire
andej një dritë dhe një hije e saj si bregu në blerim
këndej një mal i thatë, mes një lumi është pa drunj
me gurë rrokullisur në shkretëtirë.
Andej si këtej janë dy faqe të një rrënje
të dyjat në brigje të hijeve të rënda

njëra faqe shprese, e tjetra përpjekje,
njëra lutje e tjetra mallkim
e bekimi ruhet në qenien e të dyjave
pa zë, pa fjalë, pa psherëtima si gjeth i jetës së blertë
krejt yjet e natës janë gjysma e dritës
dhe hëna e purpurt në gjysmëhijen e brigjeve
dhe nën malin e shenjtë burimet tona rrëmbyeshëm janë
dhe ruhen në amshim, si vetë gjaku dhe shkaba e moteve
dhe nata jonë përthyhet në brigje si vetë jeta e përditshme
si mundimi në përpjekjen tonë të gjatë dhe shpresa në yllin e zemrës
si vetë gjaku ynë i kaltër prej olimpi në fluturimin e zogut të shenjtë
dhe e ardhmja jonë si pritjet e gjata
sikur ecën ende brigjeve të hijeve të errëta të natës.
Ne, nata dhe hijet tona kemi marrë përmasën
e përthyerjeve të viteve të shekujve ndër mote
sipër maleve të ashpra te pragu i mëngjeseve,
si hije të përthyera në dritën hënore ndër brigje.

SI GJETHI NË SHKËMB

Fjala
si gjethi në shkëmb
në lis është në lule
fjala
blerim i qenjes
ndjenjë është
vrull stinësh e mugullim
fjala
zë i mendjes, tingull i zemrës
vesë e ëndrrës
fjala
Pikëllim qiellor i syve të kaltër
fjala
pika shiu vijave t`ylberit
hark i magjishëm ngjyrash
fjala
shenjë guri,
fëshfërimë n`fluturim zogjsh
erëra n`bubullimë në dritë vetëtimash
fjala
Ti bukuria e çiltër, në kurorën e tingullit
Ne zëri jemi, ata janë ritmi,
Ato janë vetë Harmonia

e këngës, e dhimbjes, e gëzimit...
ti fjala e valles,
ti pëlhura e vesës, ajo kurora e luleve.
Unë gjuha e fjalës e dritares magjike të kopshtit

NJË DEGË E THATË

Një degë në vjeshtën e thatë
e rrëzuar nga pema dhe frytet
e zhveshur nga gjethet e pranverës
edhe prej ngjyrës së blertë

E thatë dega pa zogj, pa cicërima
te gjethet e shtrira në honin e erës
pluhurit përdhe e përbaltur nën shi
tretur në erë atje te lugjet e deborës

Dhe dega u nxor nga honi i stinës
nga nje dashuri e fortë, e marrë
dhe të rinjtë kërkonin dritat e erës
t'i varrnin vigut të kohës sipër saj

Dega në vazo ishte shenjë e ngrirë
te dritarja qëndronte në ngjyrë të thatë
e në krevat ndizej në zjarre një dashuri
dhe dega qëndronte si hije e qiririt pa dritë

Dhe degën e pagëzuan më pas të dytë
e pranë saj po treteshin si ngjyra e gjethit
e stolisën më pas me dritat e zemrave ku i varnin si sytë
dhe e quajtën kjo është kurora, dritare e dashurisë

Dega si statujë, ndriste si hije te dritarja e zbehtë
matanë xhamave ishte borë dhe ftoftë dhe errësirë
e në dhomë ngrohej nata duke u djegur një dashuri
dhe pranë tyre dega e ftohtë pa jetë, e mpirë si vig i ngjitur sipër
të errtës

DIKU

Si e vërteta e qiellit
është ngjyra e saj e shtrirë

Si fërshfërimës n`krahët e lejlekut
drita bartet në qafën e gjatë

Te fusha e gjerë stinët bien
dheun e kthejnë në ngjyrën e tyre

Në gungat e tokës janë drunjtë prej gjethi
në lugje si qielli rrjedh hija e tij ndër gurë

Njeriu dhe hija si kepi në dy të kundërtat
në kryqin e thurur të njëri-tjetrit

Ajo ëndërron fluturimin e zogut
si kurora në hijen e saj të dritës

Dhe lisat mbi gunga në shenjat e fluturimit
njëra faqe ndrit e tjetra në freskinë e hijes

DIKUR

Dikur ishim parë diku
po ku tani s‘e di
vetëm di se s`të harrova kurrë
në ëndrrën e viteve të syve të verbër
Si dikur më thotë ëndrra edhe sot
ishim të lumtur të dytë sikur qielli
e të shtrirë në ajër ishim të dytë
duart në mbrëmje i vinim te hëna
sipër blerimit si sorkadhe vrapoje
unë i verbri të shihja si n`hije
si hënën të ndieja kur luaje mbi bar,
jo tej bregut diku atje, por në siluetën e muzgut pranë.
Dhe kujtesa jonë u mbush plot gjurmë
shenja takimi në trup, në gji, në buzë
e kudo ishim ne dhe buzët tona
shtriheshim të tërbuar në afshin rinor
si brigjet, si fushat nën barin e gjelbër
e ne sipër barit ishim shenjat e flamurit tonë
të trupit tonë, të buzëve tona dhe gjinjve të tu.
Kujtesa jonë shkoi në vrapin e harresës
dhe në ëndrrën tonë ajo u struk në fund
as shenjat në stinën tjetër mbi bar më nuk ishin
po fluturonin errësirës diku,
sipër një varri të blertë të kohës rinore.

Dhe të kujtoj i verbër si tani, strukur thellë në ëndrrat e mia
si atëherë kur ishte duke u djegë kandilit silueta jote,
e në dritën e natës shtriheshim me tërbim
tej për tej afshit tonë.

KURORA E LULES

Petale me ngjyra fushash e malesh,
burimet dhe bari i blertë
shenja fluturimi dhe erëra kohësh
në zërin e fëshfëritjes së puhive në degë

Në petale si kurora bukurie,
në lule malesh dhe shkëmbinj
në sy të qiellit të kthjellët të kaltër
ku lind e perëndon si dielli n`shkëlqim

Pëlhurë e zemrës në cipë të ashtit
është sa vitet e saj të thella
te burimi i të gjitha moteve
ngjyrë e lules në sy të qiellit

Ti lidhe brigje dhe mote
gurgullove krejt burimet
mugullove frytet dhe stinët
n`ashtin tonë je shtizë e jetës

Sipër shtize kurorë kohësh
lulekuqe shtrirë petalesh
si pëlhurë në pika vese
n`hark të jetës dritësojnë motmotet.

BRAKTISJA

Ajo vendosi ta braktisë vetminë
e gjithçka të saj që lidhej me të
Në shtratin prej druri i la buzët si shenja
me një puthje të lehtë malli
Shtratit i la përmasën e skeletit
E korridorit ia la fshamën e trishtë
si nën pelerinë të vetmisë ishte
lëkura e saj e pritjeve shterpë
Në kuzhinë, në tavolinë
e la briskun e bukës pranë
shportës me mollë dhe portokaj
Brisku ndriste mes pemësh
i mprehtë, i vezullueshëm
Në xhamat e dritares la fytyrën e saj
me pamjen e fundit dhe me sytë e zinj
si në vijat e mjegullës dhe avullit
i vizatonte me gishta
dhe shikimi rrëshqiste qelqit
Para pasqyrës e la veten e tërë
si një leckë tashmë qe po shkon në pakthim
e mbi karrige e vuri kapelën jeshile
pranë saj edhe vellon si hije të vetmisë
e në derë e vari shallin e punuar
dikur me buzëqeshje si sythe te çelura

e la varur si një lule muri
Dhe shkallëve e la shtrirë zërin e takave
harmonishëm si vetë braktisja e vonuar
dhe jashtë skajeve nëpër trotuar
ishte hija e saj e dritës
e trupit të saj të prajshëm
e flokët i luhateshin në ecje
si në puhinë e erës së mbrëmjes
e tëra dukej si një gjeth i lehtë
e këputur me dëshirë
dhe e tëra po ecte në dritën e syve
si një mjellmë e bardhë pranë kopshtit, pranë lumit,
E te bregu e la hijen e vet të fundit si shkëlqim
në rrjedhën e fëshfërimës si pema e erës
u trete si në krahët e kohës plot dritë me këngën e zgjimit

RRJEDH LUMI

Lumi rrjedh nëpër gurë
e gurët nëpër rërë dhe baltë
skajet si brigje lozonjare
në ngjyrën e beharit të blertë
Rrjedh uji nga malet, nën lisat e gjatë
nën gurët e lartë të bjeshkëve
nga thellësi të errëta të dashurisë prej dheu
i dëshirueshëm rrëshqet si koha
në shtratin e kthesave të erës
me sytë e tij të verbër, shijon ngjyrat ndër bimë
gjallëron, gjallërinë, gjallërueshëm kudo
dhe pikat e saj shtrihen pikimit të shtratit të gurrës
rreth tij ka drunj, gjethe dhe bar
E lumi vjen nga errësira e thellë
dhe gjithçka është nën lëkurën e
bukur të stinëve
vetë është kuptimi i dashurisë, i mugullimit dhe
stinës së vyshkur
Përsëritjeve e rilindjeve pa fund te burimi i natës
së përjetshme
shtratit të tij të ngjyrtë si jeta vjen si guva e syve,
si yjtë në qiell, si hëna e verbër
Secila janë në fytyrë të secilës si pasqyrë e përjetshme
e njëra-tjetrës

si nata e errët thellë e ngjizur me dritë në gjethin e kaltër
te ndjenja e qenies
në njëri-tjetrin mbahen në shpinë, në erë, në gjithësinë e tyre
të verbër si një gjysmëvesë mëngjesi

TI E TËRA

E tëra në të tërën
ti je gur në gur
hije në hije dhe
dritë në dritë
Ti dëshira në dëshirë
fytyra je në fytyrë
trup në trup
Ti në esencën e lindjes
në burim të burimit
e në zjarr të zjarrit
Ti je sy në sytë
ti je buzë në buzë
ti mish në mish
ndjenjë në ndjenjë
dhimbje në dhimbje
dhe asht je në asht
ti frymë në erë
pikëllim dhe zë në fjalë
shenjë në shenjë
ritëm në këngë
ti harmonia e së ndryshmes
dhe stinë në stinë
Ti jeta në jetë

dhe e tëra në të tërën
Ti psherëtima e gjthçkaje
në gjithçka

SHENJAT E FLUTURIMIT

Fluturuan zogjtë nën qiellin e vjeshtës
shkuan si gjethet brigjeve të erës
dhe puplat i linin si shenja të kthimit
në udhën e tyre sipër shkëmbinjve
Fluturuan si ditët e verdha të stinës
si rrugëve dhe trotuareve të qytetit
që trokisnin takat e kepucëve
nepër zhurmat e veturës
E mbi gjethe ecnin njerëz
në fytyra të kohës me rrudha të thella
si pemë të këputura n`erëra ftoi
E lumi ecën n`udhëtimin e valëve
matanë zëri i korbit me hardhucë ndër gurë
shpatit të thatë si vjeshta e ftohtë me re muzgu
Lumi në sytë e hirtë të pikëllimit
dhe gjysma në tymin e reve të natës
e gjysma tjetër në zërin e patave
si hije petalesh prane bregut me brymë
E në degët e zhveshura të pemës
ka shenja të fluturimit të zogjve
dhe gjurmë të këngëve të beharit

N`SYRIN E DITËS

Një mbrëmje me ëndrra
të kaltra
nën yjet e ndezur
e në prarim të hënës
strukur nën qepallë
të perëndimit
Gjurmëve të natës
thellë atje
shfaqej si drita
një fytyrë e hijshme
Te dritarja varej si flakëz
rrethuar me xixa të natës
si shpresa e ndritur në dëshira
si në bredhin e vjetër
Është natë
dhe syri i ëndrrës
me shpresë
udhëtonte
ditës së re.
Si të ishte në shpinë
të hënës
në hapësirën e kaltër
për te fytyra e saj
Është udhë dimri

dhe jemi afër
mes buzëve të humnerave
dhe bregut të ëndrrës
E lajmëtarët e erërave të ftohta
na thonin kumtin e furtunës
të reve, të yllit, të syrit të ditës dhe të motit të egër

ZË LUMI

Erë mali
Zëron lumi në valë lumi
gjethet si zë degësh zërojnë
era dhe zëri i puhisë
te lumi te gjethja te fluturimi
erë dhe zërime zogjsh
si zjarri që puhit
atje në grykë
atje te errësira e shekujve
te fytyra e përjetshme e dashurisë
ajo që ishte gjithmonë në ëndërr
pesha e zemrës dhe plaga e syrit
ajo që peshonte më shumë se jeta
më shumë se çdo gjë
më shumë se tejvdekja
e tërë bota e ëndrrës ishte në një fytyrë
në një fluturim, sipër një zjarri të heshtur
të djegur nder plagët e cicërimave
si te foletë e tyre të kthimit
në stinën e mugullimit të erës
Ajo peshonte më shumë se stinët
më shumë se pluhuri i viteve
më shumë se ëndrrat....
Një pamje dashurie

një pemë e artë
një grusht prushi të zjarrtë
një fluturim qielli në flatra lejleku
në një pamje të vetme
si në ëndrrën e artë të tretej së gjalli
në mes ujit nën valëzat e lumit
dhe më pas këngën e fundit të mjellmës
ta merrte me vete zvarrë
e ta linte shenjë blerimi sipër mbi varr

VESA NË DORË

Në dorën time
ra një vesë e ndritur
sikur pikoi mëngjesi
si në gjethin e hardhisë
të zverdhur nga moti
nga vjeshta
si nën brymë
nën pëlhurë llastiku
dhe në vetullën time ka vesë
si e paramëngjesit
ka rënë dhe shtrihet e ftoftë
e shkrihet si në shkëlqim të dëborës
Dhe nëpër gishtërinjë kanë rënë pika vese
si qelqi janë të gjitha prej mëngjesi
të paraditës janë pika si prej ballkoni të kohës së verës
Dhe vreshtat atje shtrihen në shpatije
janë nën brymën e fillimit të ditës së re
si nën pëlhurën e bardhë si dëbora prej llastiku nën qelq
Dhe vesën në dorën time e mora me vete
dhe të tjerat nëpër gishtërinjë
Në dhomë i vura të gjitha në dritare
si shenjat e ditës së stinës së verës
Dhe përmes tyre shihja shpatije pa fund
dhe vreshta dhe pemë dhe shkurre
nën ngjyrën prej najlloni si e deborës së parë

NËN PJERGULL

Pjergulla në puhizë
puhitë n`erën e lehtë
trupit të saj rrudha dhe kohë
degët e gjera si deti ne erë
në ngjyrën e vet
të moteve të lashta
gjethet e stinës dhe gungat
dhe lëkura e saj e brishtë
e ëmbël dhe e sertë.
Nën pjergull jemi
gjithmonë unë e ti,
pikën e ndritësimit të bardhë
e pikoj si bora në gotën tonë
e dashur,
e ti pikon prej frutit të kuqen e zemrës,
dhe rrëshqet sipër gurit të varrit tonë.
E gjethet janë kurora varri, si era, si fryma,
si dashuria e syve tanë qiellorë,
dhe blerimi jemi ku mugullon çdo stinë,
si te gurrë e kroit, ngjyra jote,
gungat dhe rrudhat e moteve
Nën ty jemi
Pjergull në puhizë që fryen lehtë
me degët e tua si det i blertë

MUZGU

Një buzëqeshje e vrarë
në fytyrë t`përvuajtur
në zërin e mekur si një shterim
dhe zogjtë ishin shtegtimit të madh
dhe jehonën e këngëve se dëgjonim
tani hutini në kumbullën e zhveshur
dhe qyqja në degën e mollës
e muzgu i mbrëmjes i rëndë, i errët si nata
si harku i zi në qafën e kumrisë dhe
gu-gu-të e saj
kopshtit tonë të gjerë të vjeshtës
pa gjethe
mjegull dhe retë e zbritur poshtë pikonin
si lotin
mbi barin e zverdhur dhe në tokën
pa blerim
Natë e errët pa yje pa hënë,mjegull dhe retë si
tym i vrazhdë
E te dritarja një perde e hollë, një dritë dukej atje
si xixëllonjë
e qyteti ishte i heshtur n`trishtimin e natës,
si lumi i tij
vërshimit të egër
pranë xhamit ishte një shpresë,

nje bekim nën një mallkim të vjetër
dhe eshka herë-herë ndizej si shpresë në dritaren lart
sipër kopshtit
te një ëndërr po merrte një ngjyrë si vesa e mëngjesit
në brerore
në kalimin e gjysmënatës së trishtë, për të agu i dritës pa
flakë, pa kandil, pa shkrepëse
vetëm ishin dashuria, ëndrra dhe vesa, si lule e çelur e dy të
dashuruarve nën eshkën e moteve
E lumi vërshonte egërsisht, si mjegulla nën
retë e kohës
si moti i thatë në degët e mollës e të kumbullës dhe sipër barit
verdhake të vjeshtës,
e në xhamin e dritares vijëzonte herë-herë përftimit flakëza e
eshkës

PËRFTIMI

N`bukurinë
tënde
e dashur
pushuam
n`përftim
të dytë
përgjithmonë
Në petalet
e lule-harrimit
Aty pranë
lule-vdekjes
Dhe në hijen
e zogut
u tretëm
Si hirit
të lashtë
ringjallur
n`agun e kohës

DRI`

Ti dri`bardhë
si valët e tua
të bardha
I nemur je
ti dri`ziu n`dri`lumin
e shtratit tënd
n`lumë drini
Dri Drini në bardhë-lumë
e lumë-zi n`rrjedhën
e burimit tragjik
të kohës vrastare shtrati yt.
Gur në gurë e shkumë në shkumë
si vala në valë prej qiell-tokës dhe kohës
dhe vetë ti je
në valët e tua te ritmit të natës.
Të ditës si valëz shkume të bardhë
në ujin si krua mali ku rrjedh me ngjyrë qielli
dhe mbi gurët e zinj Dri-ziu nëpër plagët e trupit tënd.
Ti etje drini në dri mallkimi je,
ne dri`bardhin e mëngjesit të artë
të ëndrrës ku rri varur prapa natës së shekullit të egër

KUJTOHEMI

Një ditë do të kujtohemi
si nëpër pluhurin e harresës
kur era fryn nga jugu
kur fryn nga veriu
si dielli kur ndriçon e në udhën
e perëndimit bëhet flakë e ndezur.
Kujtohemi një ditë udhëve tona,
si ishim dikur në rininë e luleve,
nëpër fushat dhe lugjet si bozhure,
ecnim si në valle fluturash gazmore.
Do kujtohemi në shikimet e blerta
në kurora lulesh të majit,
si në faqet e librave kur lexonim,
dashurinë tonë fisnike me vyrtytin.
E ne kujtohemi edhe në vazo trëndafilash
si në një laps të thjeshtë në fletore,
shenjat e buzëve me petale lulesh të kuqe,
shënonim emrat e endërrimeve tona.
Një ditë do të kemi kohë të ulemi e të mendojmë
se si njëherë jetuam si të gjithë,
por secili nga ne ishim në botën tonë.
E si do thonë e do shkruajnë për ne
se ishim të dështuar apo të vuajtur si të tjerët në jetë,
apo nga dashuria e tepërt u bëmë copë-copë

sa shumë dhuruam puthje, sa shumë gëzime pa fund.
Dhe tani nën gurin e bardhë tretemi të vetmuar,
dhe gotën me verë, pinë të vjetër deri në fund,
pluhurin kur ta shpërfaqë si kujtim era e jugut.
Saherë lind dielli me dritë e shkëlqim,
e si zjarri i skuqur atje ne mal ku perëndon
dhe natën me hënë kur e bekoni
me nje laps të thjeshtë me pak fjalë në buzë
Oh, të qofshim falë ty dashuri e jetës.....
që pikon si hëna dritën e verës, te zemra ime e natës.

KUR E PASHË

Kur e pashë atë n`fytyrë
si hënëza në shteg të malit
Sikur u treta në harrim
si yll i qiellit në shkëlqim
Ishte çast krejt i vetëm
ku ndrisnim përballë të dytë
n`bukuri të njëri-tjetrit
sipër barit me gjelbërim
Një pasdite ish hyjnore,
koha ndriste plot hijeshi
n`rreze bjeshke shtegut t`syrit
plot hare ishte n`prarim.
Varr i kohës n`gjeth të qiellit
ish çasti ynë...
Si vetë agu që s`perëndon
dhe u bëmë si re t`bardha
n`qiell tuj ndritë mbi harrim!

FUSHA DHE BRIGJE

Fushat e gjera si mëngjesi i ditës
si dita në erërat e veriut dhe shiut
bari gjithkah dhe lulet e verës
shtrirë si blerimit të gjitha bimët
dhe pemët janë të blerta, të bardha
e të kuqe janë si fruta të pjekura
vere dhe kosa e barit të etur
dhe etja si zverdhje palosur nën erë
E dielli pas shiut i ngjesh si fletën me fletë
n`lugje dhe përroska brigjeve vijnë
te lumi shtrihen tej brigjeve të tjera kalojnë
dhe dielli i vë nën afshin e djerrës
si mollëkuqet e verës kur erëzojnë nën hënëz
te krevati në çarçafin e mendafshtë
kur dashnori vjen nën hënëzën e butë
nën dritëzën e beftë si hije e zemrës
dhe natë e verës është dhe hëna e plotë
vallëzon në fusha dhe në brigje
si dita e gjerë e pafundme,
si afshi i diellit në ditët e verës
dhe ajo e pret të dashurin si hije
kur vjen pa u diktuar te erëmolla e saj
sipër çarçafit pranë të dashurës
dhe erërat me bubullimat e shiut dhe dielli i verës së etur

e në freski hëna sipër të blertës e fushës gjallërueshëm valëzon
dhe i puth brigjet afër dhe larg sa vete qielli nën të
e në dritëzën e saj erëzojnë mollëkuqet
e dashnori në hijen e vet duke e lënë mënjanë
afrohet si pa u diktuar afër dy mollave të zjarrta
në lëkurë të bardhë, n`afshin e saj.

SY E DRITË

Sy e dritë - është si lule
trupgjatë si qiri
beli saj si pishë në mal
e brishtë është ngjizur
në mall
Si hënëz është ndritë
natë për natë
sipër pjergullës te dritarja
aty nën xham
Sipër kandilit flakë e saj
digjet ngjizet me shumë mall
Pikon dëshirë si vaj në zjarr
n`yll të saj atje lart
n`qiell të natës dritë e saj
hov i zemrës ngjyrë e bardhë
shpirti i digjet pa pra
pikon lotin trupit me mall
për yll t`errësirës
afër nën xham
sipër pjergullës dëshirë e saj

PAS MESNATE

Mbrëmë vonë, pas mesnate
isha i pirë si dru i pishës, në honin i etur
shishe birrash të mëdha e të rënda
dhe shërbyesja e bukur e re
e bardhë si kandili
Dhe sytë e saj më bënin dritë të vetme
si ëndërr ndrisnin para fytyrës
dhe qeshja si në tërbim
e këndoja si një zog në dritare
e duart i luaja si një dirigjent
në ritmin e dritës së syve si t`kandilit
Dhe shërbyesja qeshte me zë
edhe një shishe tjetër të lutem
më thoshte
dhe te koka mbështeste gjoksin
Tani jemi në paramëngjes
si kapela ime thoshte në pritje
si palltoja e natës së dimrit
si këpucët e rënda të borës
si fundi i saj pranë zjarrit
lëkura e përskuqur si avull i lehtë
pranë më bënte të ndjeshëm e të ashpër
pija si i çmenduri në vetminë e shekullit
si dashnor i varfër që pret pjesën e qenies

dhe i pirë si druri i zjarrit prej pishe
me ngjyrën e thatë si hiri i natës.
Natës me ngrica vetmie e me dëborë
sytë e saj më jepnin shpresë dhe dritë
si kandilat e mesnatës ku digjeshim mbrëmë
trupit tonë të lodhur e të ndjeshëm si gota e birrës
dhe në gotë si në gjoksin e saj mbështesja kokën
nën dritën e zjarrit të zemrës së natës
dhe nata ishte në krejt dritaren tonë
si kënga ime prej zogu të kohës
në degët e blerimit sipër lumit te avullt
Në ëndrrën e gjatë si kujtim i lashtë
ajo si gota prej qelqi në duart e mia
pinim birrën bashkë deri në fund
si dy te çmendurit e natës së dehur
lamtumira jonë vinte duke u tretë errësirën e vakët
si gota e qelqit përmbysur në shkumën e birrës

VESË NË GJETH

Ti pikon vesë në gjeth të pjergullës
si rreze mëngjesi në sytë e kaltër
si vetullëz hëne në shtegun e prarimit
si drita e vakët e petaleve të blerta
Ti vesë pikon në të gjitha gjethet
si dritarja e kopshtit pranë ullirit të gjelbër
dritë në qelqin tënd si qielli
dhe yjet i tret në syrin tënd
si xixëllonja te ti vijnë
dhe treten aty si në shtegun e hënës
Ti pikon vesë në vesën e kohës
dhe kujtimin tënd dhe lotin tënd
Ti që përditë ndrit dhe përditë murosesh
dhe ti përditë vdes si dita në kepin e perëndimit
Dhe në syrin e Hënës pikojnë si vesa dritësime yjesh
dhe kopshti yt i gjelbër si jeta
si gjethi i blertë n`erën e lules
dhe ti e vetme je qe kurrë s`perëndon
dhe une në vesën si qelqit të syrit tënd pikoj

FILLIM I RI

A është njëmend një ndërrim i ri
një dashuri e re apo e përtërirë
në ditën e motit të ri pas natës
si lulishte ngjyrash bredhi i shtëpisë
Gëzuar themi duke qeshur të gjithë
dhe asnjë qeshje s'është e njëjtë
te secila rëndon një përvujtni
ka një dëshirë të mbetur peng
Gëzuar të jemi shëndoshë të gjithë
prindërit e gjyshërit urojnë
dhe fëmijët tanë thonë të kenë begati
e të gjithë fëmijët të kenë fëmijëri
si bredhi ynë që ndrit si lulishte
në ngjyra llastiku e në poçe qelqi
si babadimri që vjen diku nga qielli
e fëmijve u sjell një ëndërr që ndrit
si ylli lart e tutje një hënëz
te xhami buzëqeshin si fytyra fëmijësh
si me babadimrin të jenë të gjithë
bashkë ngjitur në valle te qielli i yjeve
e në krahët e hënëzës me ëndrrën e tyre
sikur pranë bredhit me drita dhe ngjyra
si zemra e çiltër e fëmijve, e në gjumin e artë
e të hënëza në vallen e yjve, e në lulishte.

GOTA

Gota e qelqit u zbraz
per ty mike thashë „Gëzuar!“
Dhe gotën e mbusha
me pamjen tënde
në urimin e zemrës
me dritë të syve
ish hija e haresë tënde
si në verën e mirë të trëndafilit
Gota ishte e zbrazët qëmoti pa ty
dhe gota u mbush me kujtime
si vreshtat që mugullojnë nën gjethet
e sytheve të stinës së kaluar
Gota si jeta me plot boshllëqe
herë ndrit si hënëza
herë shkëlqen e purpurt si nën yje.
Herë është në lëngun e bekuar
të të gjitha luleve
si vera e trëndafilit qiellor pas zjarrit
dhe gota e vetmia jonë e vetme
si lumi në amshimin e heshtur
si bari i bleruar në qetësinë e natyrës
si fjala në dritën e saj, e në hijen e fjalës
si dheu, si pluhuri, si gurët dhe oxhaku ynë
ne dhe xhami i jetës në gotën prej qelqi

Ti shkaba në lashtesinë time, princeshë e moteve
dhe Shqipëria dhe gjuha në një bekim të vetëm
ju që shembët dhe ndërtuat kohët,
ju që flijuat veten dhe pavdekesinë në altar
ju që ndrisni në kurorë malesh si
gota dhe trëndafili qiellor në dashurinë e zjarrit

N`SOKAKUN TONË

Kur hëna del
n`sokakun tonë,
si hije përfton, moj
n`vetëtimë qielli.
N`bukurinë e hënës,
t`rrëmben si kometa
si flokët e shprishura
te era kur fryn
o, moj kaçurrele.
Si gjethet te pemët
kur fëshfërijnë në kopësht
sikur vetë të thonë,
oj e mira moj
po na ndrit si hëna.
Sonte fije-fije
si netëve me hënë
plot rreze fytyre
kaçurrele moj
Ecën si hije e zjarrit
në mbrëmjen e vonë
në sokakun tonë.
Është më hënë se hëna
çupa e lagjes sonë
mall e dritë e lagjes,

flakë e shpirtit tonë.
Në sytë e djelmërisë
n`afsh të dashurisë.
E n`gur mbi gurë
ajo kur kalon,
e nur i saj seç shkrep
te zemër e beqarisë.
E në dritë të hënës
belhollë e flokartë
si prej vetëtime
përfton pamja e saj.
Në kandil me shije
flakëzë e saj digjet
errësirës fije-fije
mbi vaj dashurie.
Është më hënë se hëna
me dritë bukurie.

NDARJA

Gjashtë shekuj pa dritë lirie
mbijetesës në përpjekje të vështirë
ishte qenia jonë dhe virtytet
si në hije-diellin e vetmisë
E qyteti ynë u nda në mes
ka nje shekull pa u parë të dytë
një errësirë korbash ishte pa hënë
në vija ndalese dhe trishtimi
dhe qiellit s`dukeshin as yjet
I mungonim njëri-tjetrit shumë
na mungonin yjet e natës
dhe hëna dhe drita e saj
në dritaren tonë s'vinte mëngjesi
Ndarja mallkimi ynë i shekujve
dhe ne duheshim e duhemi prapë
ashtu ruaja si bekim pamjen tënde
e ruaj edhe tani si përnatë.
Ne dy gjysmat e qenies e të virtytit
dy gjysmat e diellit tonë e dritëhënës së natës
jemi dy gjysmat e qytetit të ndarë,
pa njëra-tjetrën s' plotësohemi dot,
në hijen e sho-shoqes si eshkë ndrit dhimbja
dhe seç pikon një mall.

BREGUT TË DETIT

Fryn stina prej deti fryn
bie valë uji të njelmëta
dhe vala humb nën valë
frynë juga e njelmët e brigjeve
I kaltër është uji i detit të gjerë
e gjerësia e tij ka brigje e valë
erë peshku të kripur dhe shkumë
Bregut të detit ka bar të njelmët
ka pemë me erë deti dhe peshku
dhe brigje si valë dhe gurë dhe zuzarë
Fryn dhe përkund era peshkatarët
përkunden në erë edhe frutat në degë
e gjethet e blerta janë të forta ende
ende s'e kanë ndie trishtimin e trazuar
se nuk e kujtojnë ato sikur degët
se si ishte në motin e shkuar rrebeshi
se si mbijetuan marinarët
brigjeve të egra të detit të kaltër
e fanarët si i kanë lënë në fund të detit
e pemët në degët e thyera qëndruan
dhe sythet e çelura prapë kanë fryte
dhe marinarët kërkojnë këtë verë fanarët
dhe brigjeve pemët luhaten
degëve me gjethet e blerta

dhe peshku, era dhe deti valë-valë ngritet dhe bie
dhe bari i brigjeve ka erë krype deti
e peshkatarët e presin mbrëmjen pa fanare në varkat e tyre prej druri...

QERSHORI

Qershori i gjelbër me lule
dhe kurorat e shtrira sipër barit
me ngjyrat e natyrës n`prehërin e erës
krejt muaji është i paramollëkuqeve
i qershive të pjekura e të rëna në tokë
nepër barin e blertë e në manaferra
dhe luleve t`vertikales së erës të pashartuara
shtëpitë janë me dritare të hapura,
perde të holla nate në dritën e qiririt
e në tavolinë është qershia e butë dhe e egër
është kumbulla e pjekur dhe lëngu i saj i sertë
e nata pa mollëkuqe e qershori me puhi të ngrohtë
E qiriri digjet dhe pikon lotin e dashurisë e të mallit
nën flakën e tij drita dhe gezimi janë si hije në një lojë të filluar
dhe ora e murit e prishe qetësinë në ritmin e minutave
E molla ka lidhur frutat në kurorën e luleve
dhe nata është e qetë në puhizë të gjetheve
e në dritaret e hapura ka dritë qiriri pas perdeve të verdha
dhe dashuria duke u tretur në errësirën si hije në lulet e egra
në qershorin ku pikojnë qershitë e paramollëkuqeve

PASIONI

Ëndrra si pasion i lindur
e pasioni në ëndrrën e jetës
dhe jeta në hovin e dashurisë
e dashuria fillimi i fillimeve
Fillimi zë fill në bërthamë
bërthama në pipth qenjeje
bimë, gur dhe gjethe
dhe erë e pafundme
e më pas hiqi e prapë qenie
thepe shkëmbinjsh
Ëndrra pasion dhe dete
fusha blerimi dhe lule
plazhe kokërrza rëre
dhe gjurmë erërash e frutash
dhe hije nate në dhomë
dritëhëne dhe yjesh pa anë
dhe gjurmët e tavolinës
pamje në pasqyrën e ditës
dhe aroma e dashurisë
në dhomën e përtrirjes
aty ku asgjëja e merr
kuptimin e qenies
dhe pasioni në burimet e jetës
e në gjurmët te shkëmbi pranë detit

ku erërat rrihen mes vete në ritmin e valëve
dhe fusha dhe qielli dhe lumenjtë
ku rrjedhin prej guvave si nata e tyre e ngjizur

NË NJË FJALË

Thuaje fjalën e le të digjet pa pushim
dhe të shihemi bashkë në një shikim
si nën hënën e zemrës ajo të ndritë
të pikojë dëshirë e mall dhe harrim
Thuaje fjalën në emrin tonë
të dytë do të mbulohemi si në një dritë
si zjarrit të digjeshim njëherësh
dhe Fjalën te guri ta lëmë si kujtim
Thuaje mendimin e njëjtë si përherë
se jeta s`është ndryshe për të dytë
sepse jemi vetë shkëlqimi i vdekjes
në kupën e harrimit tonë
përgjithmonë
Thuaje si është rrahja e zemrës
se është pritje si hiri në erë e padurim
dhe e nesërmja s`dihet më a do të jetë
ashtu si tani çastit në amshim
Si vijës së pëlhurës si ndrit me gëzim
dhe syte pikojnë pikëllimin e shkëlqimit
sipër humnerës këtu të dytë
ndrite gëzimi ynë buzë errësirës
Thuaje emrin e pemës së botës që u lind
dhe merre me vete në amshim të bukur
dhe unë do ta bart si dritën e jetës

me verbimin e dhimbjes për të dytë
Thuaje se ne po vdesim të lumtur
e te guri do jemi përherë cak dhe fole zogjsh
aty ku është kupa qiellore në dritën e vdekjes
dhe harmonia e tingujve e te gjithë qiejve
Thuaje se u bë vonë fjalën e nesërme
mendimin dhe kohën e çastit t`yjeve
se tani ngadalë do kalojmë në anën tjetër
atje tej humnerës
dhe në zemrën tonë do të pushojmë
e te guri do te digjemi si kandil,
vuajtje dhe dritë prej syve do të pikojmë

LULEDIMRI

Luledimri në petale t`bardha
si dritë e kurorës shtrirë n`errësirë

E në errësirë kur del në qiell hëna
si vesë në petale ndritësohet nata

Janari i kopshtit i bardhë me acar
mbuluar si pëlhurë me fjolla veriu

Dhe luledimri si zemra në erë
petalet e shtrira si kurorë dëbore

Kurorë e saj ndriste e ndriste si hëna
në vesë pikon si qelqit dëshira dhe ëndrra

Luledimri si pëlhurë e mëndafshtë
në deborë është si hëna në acar

E ngrohtë si oxhaku në ndjesinë e zemrës
te kopshti ynë si hënëz është vesë e saj

DITA

Filloi dita sot
si në mëngjesin e trembur
të dimrit
dhe shenjat e zogjve
e puplat në deborë
Trokitja e tyre
me cicërimat në xham
dhe flatrat si hije në dritare
Nën çati rrijnë e zbresin mbi dëborë
degëve të kumbullës
si shenja le zërin e tyre
Po udhët sot të ngrira si uji
si toka e mbuluar në dimrin e rëndë
dhe ne kemi ftohtë - akull në fytyrë
si ëndërr e keqe, përftim i korbit
Sot është e ndjerë dita dhe zgjimi
e kanjusha s`është, as vetë thëllënza
Sot ndoshta s`është si përditë
me ngrica dhe boshësi e nderë
se ditët ndryshojnë dhe vijnë bashke me dritën
dhe dielli kur t`ndritë pasdites si hëna
e zogjtë në dritare lënë fëshfërinë e flatrave
e te kumbulla degevët cicërojnë dhe i lënë gjurmët e tyre.

DHOMA

Hija jote kudo është
jeton në sytë e mi
në ëndërrime të përditshme
e pasditet e vështira pa ty.
Të shoh në sallon, ulur në karrige,
aty po qëndisje prore një pëlhurë
si pikturën e murit me zogj dhe dritare
dhe më tej urën e drurit dhe fushën e blertë
shelgun me qiparisat dhe bregun e kujtesës
aty ku hëna qeshte nën yje
e ne qeshnim pa pushim në rrezen e syve
Në dhomë je kudo, të ndjej si përherë
pasqyra është e mbuluar me perde
e s`mund të jetë më kurrë si më parë
As kuzhina, as pemët e freskëta, as brisku s`është
dhoma në qetësi si hija jote n`përftim,
e gjilpëra është në perde si ditën e mbramë
pret dorën tënde ta përfundojë krijimin
dhe kandili po digjet tani pa ty
dhe jeta është e vrazhdë si ferra mbi lule
e ti ëndërrimeve si peri yt i hollë ngulur në pëlhurë
në artin e pa kryer n`herën e fundit dhe e ndërprerë në kohë
e në murin e errët llamba ndrit dhe pikon qiriri si zemra ime
kujtimin tënd

NË HIJEN E DRITËS

Aty është vetja
dhe hapi i kohës
në zemrën e heshtjes
në fuqinë e qenies
në përmasën e dritës
Aty është guximi
dhe pema dhe farërat
me erën e zogut në fluturim
Fryma e dritës e shenjat në gur
në gjethe e në petale të lules
qiellore është me sytë e kaltër
në harkun e jetës
Udhë me pishtarë të mbrëmjes
hije drite si toka pjellore
n`shkëlqim të palcës, shenjë e fitores
fanar xixëllonjash dhe zogj
shenja dhe gur dhe pema e frymës
udhë e dritës dhe përmasa e hijes
E atyre qe u bënë flaka e jetës
dhe hapa në hijen e dritës së tyre

MOS U BËN !

Mos u bën lumë në lumë
Mos u bën as hi në hi
as shtrat i lumit mos u bë
as djall i djallit kurrë mos ëndërro
mos u bën as engjëll i engjëllit
s`duhet të jesh ai që nuk je
...as yll i yllit, as dritë e dritës
as i ditur i të diturit
mos u ben...hero i heroit
as thembër e thembrës
as shkëmb i shkëmbit
as breg i bregut
as hije e lisave të ftohtë
as terr i territ të askujt
as dritë e dritës për askë
bëhu drita jote e ashtit tënd
në hirin dhe pluhurin e kohës tënde
as diell i diellit, as mëngjes i mëngjesit
as mbrëmje e mbrëmjes, as fjalë e fjalës
mos u ben zjarr i zjarrit, as hije e tij për askë
ti fjala jote bëhu, zjarri dhe drita jote
bëhu toka dhe flijimi yt
gjaku si gurrë uji i kroit të të shkojë.
Bëhu gjithçka e lindur në trupin

e mendjes e dritën e syve tu
në lum-lumin e moteve të arta
flijohu dhe bëhu vetvetja në tempullin tënd
dhe njohje e pambarim e gjithë diturisë
të pafund dhe bëhu dashuri në bekim të vendit dhe gurthemelit tënd
aty ku ruhet në palcën e ashtit ndër mote të thella shkaba hyjnore e qiellit tonë

ULLIRI

Ulliri dhe ne, në prehërin e tij
në dheun e brishtë të kodrës
rrënjet e shekujve si palë vitesh ulliri
degët dhe frutet e shumta
zogjtë, thëllënzat dhe pëllumbat
si kurorë e degëve të trungut
këngë dhe ne pranë-pranë në shikime
dashuri, gëzim dhe hove zemre
Në prehërin e tij ka dhe shekuj
lëng jete dhe trishtime kohërash
sy dhe gojë në buzët e fluturimit si era
si fryma jonë prej qielli
si kurora e shenjtë e ullirit
si shtërgu në hapësirën e gjerë
dhe gota jonë e dashurisë
qelqit të ngjyrosur me lëngun e lulebregut
dhe lugjeve rrjedhin kurora yjesh
dhe ne në qeshje të mbramë
u bashkuam në çastin e gëzimit
në prehërin e ullirit ishim si ëndërr
në një gotë shiheshim të dytë
si një hyjni në prarim fruti
dhe u bekuam si ylli në hënë
e hëna ishte e ndritur si lëkurë e pjeshkës

si të merrnim degët me frytet e shekujve
bashkë vallëzonim deri ne agim si fryma,
si puhia e çastit të të gjithë shekujve, të kohës që s`perëndon

JANARI

Janari i votrës së shekujve
zjarri i natës dhe flaka e dritës
hiri dhe rilindjet e kohës
në qiellin e kaltër
krua në lumin e shkëmbit
Janari acar me dhimbje
hiri i ringjallur i moteve
në pavdekësinë e shkabës
Si deti i pafund
si toka dhe gurët e bardhë
dhe tymi i qiellit të lashtë
në tempullin e shenjtë të lirisë
kujtesëpërtërirje dhe pavdekësi
Janari i skuqur dhunisht në pabesi
janari i guximtarëve të kohës
janari i moteve të mëdha
me gjakun e dritës e të kujtimit
dhe fjala si flaka e zjarrit ndër shekuj
si qielli ynë i praruar dhe i kaltër
Si lumi në kohën e jetës
Janari i zjarrit të votrës, i flakës së dritës
janari i kaltër dhe hyjnor si pema e praruar e guximit
si ngjyra e pëlhurës sonë të kuqe që bart shkabën e mosvdekjes

DRITARJA

Dritarja jote është n`fytyrë të qeshur
si perdet e kaltra me ngjyra fluturash
e ballkoni yt pa lule është
Por ti je vetë lulja e tejxhamit
dhe kuptimi i ndjesisë n`pamje qiellore
E ditët si do të ishin pa ty
kur do te kaloja pranë dritares sate
dhe të mendoja se ti më s'je aty
as s`më shikon më pranë perdes së kaltër
as fluturat me ngjyrat e shumta
s`do valëzonin më në duart e tua
dhe xhamat ti më s'do t'i hapje
as s`do t'i pastroje më si përherë
dhe unë do te mbetesha krejt i varfër
udhës sime në kalim të përditshëm
Por, të falem ty dhe dashurisë sate
qe je e ndjeshme dhe e mirë
dhe ti më buzëqesh si përditë
e më shikon dhe ma jep dritën tënde
Edhe lulet e botës në ballkon t'i kishe
sa ti s'do të bënin asnjëra dëlirësi drite
Ah, pamja jote është dëshirë e përditshme
e pa ty e gjithë bota boshësi do të ishte
e qielli s`do të ishte më i kaltër

as dritarja jote as udha pranë s'do të ishte më
si perdja e ndritur në duart e tua, as fluturat me ngjyra të ndryshme

NATË

Ti je në zemër të lumtur
fjala jote si shkrepje drite
me ndjenjën e këngës
si ritmi i shiut të pasdites
E nën çati këndojnë zogjtë
në dashurinë e tyre të bukur
lozin si shikimet tona
në çastin e takimit
dhe ecja jote
dhe taket e tua
dhe hija mbi gjethe
dhe pamja në ujin e liqenit
në mbrëmjen e qetë qielli dhe yjet
e blirët dhe shelgjet
e në liqen janë hijet e degëve dhe gjethet
e taket në harmoninë e ecjes
e nata në dritën e hënës
dhe gërshetat e tua
si ëndërr e natës
si fjalë e prarueme
si mjellmë e bardhë trupi yt
si ritmi i këngës n`ujin e qetë
ti dhe liqeni n`bukuri mjellmash
ti dhe hija jote si hënë ndriste natës pa fund

NË VIGUN E DRITËS

Në vigun e dritës
kohë dhe hapësirë
liqej dhe ngjyra e mjellmës
natë e ftohte e pafund
dhe vija e blertë dritë e qiejve
e pafund në harqe yjesh
Dhe në ecje të padukshme
sipër humnerash të vdekshme
në frymëzimin e zemrës
në dritën e dashurisë
dhe kërkimit të vetvetes
në plotësimin e pjesës së duhur
të mundshmes e të domosdoshmes
për të kaluar vijë dritën e lartësive
dhe gjurmët e padukshme të syve
dhe flaken e kërkimit në terrin e mendjes
drejt plotësimit të kohës në shenja të hapësirës
në hone, në brigje dhe në lumenj
si liqeni që e kërkon mjellmën e bardhë
Nositin dhe shtërgun e kohës
Si terri që ndrit në vijën e dritës
në harkun e kohërave të qiejve
dhe tingujt e shiun në liqen
natë e ngjyrë e mjellmës përfton

dhe hëna vallëzon qiellit mbi blerim
dhe kaltërsisë në harmoninë e zëravë të zogjve
si Nositi, si shtërgu,si mjellma, si hëna ne vigun e dritës
dhe yjet që lindin dhe perëndojnë si hije të liqenit
dhe prapë vijnë si dashuria në kepin e mbrëmjes sipër humnerës

RRETHI I KOHËS

Paralindja e qenies është ngjizja
Ah, lindja, jehonë zeri dhe vaj
si deti i paanë, në rrethin magjik
hapësirë e papërkufizuar dhe stinë
e dashuria është qenia e ndjeshme
drita e diellit dhe mëngjeset
dhe zemra e nënës e magjishme e jetës
Lindje dhe vdekje njëherësh në rrethin e kohës
harku i tij i vetëm si blerimi i stinës
si gjethet e pemëve, era dhe rrënja e ngjyrës
si fushat e verdha pas blerimit të brishtë
dhe kodrat atje ku e puthin qiellin ne sytë e vetmuar
dhe te gjithë udhëtojnë kah mbrëmja e jetës
radhë jane si brezat ndër kohëra
shenjat dhe ëndrrat i bartin kujtimeve
si deti i paane gjerësisë së vet
ne harkun e tij të vetëm dhe vorbullën e erërave
si vetë jeta e njeriut në hapat e tij te vegjël e gjigandë
vijmë në jetë duke vdekur përditë për secilin çast
si sekondat e minutave dhe orëve të kohës
përpjekjes dhe guximit dështak dhe përsëritjeve
në lojën e gurëve si pranë lumit të vogël e detit të gjerë
dhe oqeanet janë rrethi i kaltër pa fund e pa cak
Ne dhe natyra jonë e vjetër, ne dhe vdekja jonë përherë e re

ne dhe stinët e ngjyrave, përtrirja dhe shkelqimi i vrarë në sy
Oh, ne jemi ata që e shënojmë vdekejn tonë, lindjen dhe
përsëritjen e moteve

TEATËR

Shkallet e ngjitjes dhe dërrasa të thata
vazo lulesh dhe rroba klounësh
maska të shumta ftyrave të jetës
nën dhe mbi ditët e rënda
shikime në kohë dhe ngjyra të verdha
Jeta dhe pluhuri i të vërtetave
dheu dhe kockat e rënda të aktit tragjik
rrezatimi i të nesërmeve dhe duart e ndyta
dje ishte trishtimi i vdekjes nën buzët e përçmimit
sot arnime leckash si flamuj të fitoreve të rreme
ata që ishin dje pengesa dhe vrastarët e të sotmeve
me fjalët e buta si dashnorë të rremë e në paqe të mashtrimit
Maskat e rreme si dje edhe sot, loja e rëndë në aktet mashtruese
si dashuria ne thembrën e shumë fytyrave në ngjyra pranvere
dhe pranvera ishte si vazot shkallëve të drurit pa lule
dhe përbetohen se ishin të denjë, të ndershëm dhe fisnikë
nën leckat e tyre si flamuj të rremë, e paqësore të kohës
Si dashuria e lëndueme që më nuk buzëqesh
dhe dashuria është në zemrat e vërteta dhe ngjitet ngadalë
si flamur i tri kohëve në shtizën e vertikales
dhe loja e teatrit, në maska dhe ngjyra e vazo pa lule
dramë dhe aktet tragjike dhe të fitores së madhe
E vërteta ngjitet ngadalë dhe ndrit guximshëm
dashuria buzeqesh si ëndrrat tona në hirin e zjarrit të artë

vjen dhe në aktin final merr kuptimin e duhur
me rroba me shikim dhe trup të ndritur
si hyjnore dritë e mbrëmjes dhe shkëlqen në muzg
Teatri, shkallët prej druri, gurët dhe pluhuri në hirin e shprushur
loja e lundërtarit dhe koha, dhe fjala, dhe maskat,
dhe tri aktet e ndërthurura në thupra ure të fortë
mbi shkatërrimin dhe vrasjet e ndyra dhe ditët e zymta
kujtim i rëndë në ecjet tona si dritë e zbehtë
dhe në fund është fillimi i tri akteve të përditshme
si dje, si sot, si nesër, ne tri kuptime është dhimbja jonë
Një shfaqje e mbrëmjes si nata e lundërtarit
dhe fanari i tij në varkën e stuhive dhe buzëmëngjesi ynë
dhe dashuria e qeshur te qiriri i ndezur
dhe ne pikonim bashkë me dritën në fytyrën e qenjes hyjnore

PRANVERË

Është pranverë
e lumi rrjedh i qetë
me ujin e dëbores
atje prej maleve të blerta

Afër fshatit tonë valët e lumit kalojnë
e zogjtë kanë filluar të vijnë
e qielli është i qetë, kohë e puhive të erës
por fshati i kujton rrebeshet e vjeshtës

E kujton edhe qiellin e zymtë
dhe fluturimin e mbramë të korbave
dhe vetminë e hutinit mbi oxhaqet
dhe qyqen në rremën e thatë

Dhe netët e bardha të dëborës
i kujton fshati ynë si fëllënzat nën dritare
cicëronin trishtueshëm e të uritur
dhe puplat e tyre ishin të ngrohta nën çati

Tani është gjithçka në mugullim
sythe dhe lule të çelura në erëra ngjyrash
bari dhe kthimi i zogjve në degët e blerta

dhe qielli si një petale e gjerë e parambrëmjes

E fshati i kujton stinët e kaluara dhe rrebeshet

PASDITE

Pasdite... dhe ti nuk je
e hija e diellit e kaloi ftoin
dhe shkoi tutje perëndimit.
E dashur, hija jote ndjehet këtu pranë
te fruti në erën e ftoit
Unë të shoh si ditën e parë
dhe përditë n`rreze si në vesën e qerpikut
shenja e dritës përfton në fytyrën time
si ftoi në ngjyrën e verdhë varur në gjethe
Pasditet e mia s`janë si mëngjeset
kur pikon vesa te pemët e tjera
ti je përherë sikur dikur e mirë si pjeshka
dhe pjeshka pranë ftoit si ti u tret
nga era e fortë e veriut të egër
dhe emri yt është si kurorë e frutit
në erën e ëndjes, te ftoi i shartuar
dhe pasdite, e dashur, je hije dielli
te ti perëndon para te gjitha pemëve
dhe më pas të mbulon muzgu i mbrëmjeve
dhe unë në ngjyrën e ftoit si dikur të kujtoj

MËNGJESI

Një kafe mëngjesi
e pijmë përditë,
pastaj ecim udhës,
pranë kopshtit të qytetit.
Unë dhe gruja ime që s'është më,
eci bashkë me hijen e saj.
Si dashnorët në kohët antike,
tërë jetës në fytyrën e njëri-tjetrit
shiheshin të dytë edhe pas vdekjes.
Dhe silueta e saj është në krahun tim
e bart me vete plot mall e kujtime,
si degët e kopshtit në silueten
e gjetheve nen ngjyrën e borës.
Dhe eci me tej në kujtimet e ditës
me cigare të ndezur sikur ishim bashkë
në stolin e parkut.
Tymosja si të isha pranë fytyrës se saj,
dhe shtëllungat na e errësonin shkimin,
ecnim nën lisat e gjatë e të vjetër,
si pranë dëshmitarëve të dashurisë sonë
Dhe mëngjesi po ndriste mbi borë
dhe degët e lisave pikonin sipër ballit,
dhe unë e shtrëngoja siluetën nën pallto,
tymosja duhanin me ngutje, e shtëllungat i lija pas,

e ne pamjen e hirit si kurora i pershkonin lisat.
Dhe qiellit bashkoheshin me retë e ftohta
në dritën e mëngjesit të zakonshëm të dimrit

GJYSMËDRITA

Ti ishe gjysmëdrita ime
n`shkëlqimin e syve t`mi
në gjysmëterrin e thellë
si unë, ashtu edhe ti

Në harkun e frymës jemi
hije dhe gjurmë të erës
në kurorën e brigjeve
të borës
e në hijen e pishave
jemi ëndrra të vetmuar
si unazë e purpurt e hënës

Dhe hëna është gjysma-dritë
e gjysma-terr i përjetshëm
ashtu sikur është jeta jonë
në njëri-tjetrin ndrijmë,
në njeri-tjetrin errësojmë

Ne jemi fryma në shenja ere
Jemi gjysmëkujtimi i brezave
dhe gjysmëardhmëria
në sytë e ëndrrave
Si harku i hënës, unazë e ndritur

Unë e ti, etje e shkretëtirës
e dashur je si vesë n`aurorë mëngjesi
unë si gjethi i rënë në erën e thatësirës
e ti si qershia ndrite në hijen e degës

Unë ëndërroj ngjyrën tënde
formën dhe ëmbëlsinë e dritës
E ti je vetë dashuria që pikon vesën
aty në gjysmëdritën e natës nën gjethe

Në gjysmëhijen tonë, ti pikon përditë
e dashur, si unaza prej hëne e liqenit.

PAK BIOGRAFI PËR AUTORIN

XHEMAJL RUDI ka lindur më 1 mars 1965 në fshatin Savrovë, komuna e Suharekës, në Kosovë. Katër vite të shkollës fillore i kreu në fshatin e lindjes, ndërsa tetëvjeçaren në shkollën fillore "*Vëllezërit Frashëri*", në fshatin Bukosh. Prej vitit 1981 merret aktivisht me veprimtari të lëvizjes për pavarësi të Kosovës. Ka kryer shkollimin dhe ka marrë diplomën për kontabilitetit, kurse për një kohë ka studiuar për filozofi-sociologji. Më 1993 ndiqet sërish dhe detyrohet të largohet nga vendi. Momentalisht jeton në Zvicër.

Me krijimtari letrare ka filluar të merret që nga klasa e 6-të, duke vazhduar, më pas, edhe me shkrime të tjera. Botoi herë pas here poezi në periodikun shqiptar pas viteve të 90-ta. Libri i parë poetik *Rrjedhë autoktone* është botuar më 1996-të nga Shoqata "*Pjetër Bogdani*" në Zvicër, nën kujdesin dhe redaktimin e Emrush Xhemajlit.

Libri i dytë *Duke mbledhur kohën* u botua më 1999 nga Shtëpia Botuese "Dritëro" në Tiranë, nën kujdesin dhe redaktimin e Shaban Sinanit.

Libri i tretë *Dheut pjesën e vet* u botua në vitin 2001 nga Shtëpia Botuese "Shqip" në Tiranë, gjithashtu nën redaktim të Shaban Sinanit.

Libri i katërt poetik *Asgjë s`ngjan në reklama as hënorja* është botuar më 2008, në Prishtinë nga botuesi "*Faik Konica*", nën kujdesin dhe redaktimin e Nazmi Rrahmanit.

Në shkurt të vitit 2011, në Prishtinë, botoi librin e pestë poetik *Fjala e dhimbjes*.
Disa nga poezitë e autorit janë të botuara në gjuhën gjermane në Zvicër, në antologjinë *Vështrim nga dritarja e hapur*, me autorë zviceranë dhe shqiptarë, më 2005, nën kujdesin e Z.H.J.Lanksh, ndërsa disa poezi janë përkthyer në gjuhën rumune dhe janë botuar te revista "*Haemus*", nën kujdesin e Ardian Kyçykut.
Ky është libri i gjashtë poetik i këtij autori.

PËRMBAJTA

LEGJENDA.....7

ATJE.....8

VETËM TY.....10

ÇELI LULJA NË DRITARE.....11

LUTJET.....12

TE TI VIJA PËRDITË.....14

TEJ MITEVE.....15

PËRDITËSI`RITMI.....17

NJË LULE-ÇASTI.....19

SHTIZA E FJALËS.....21

E PURPURTA.....22

RRUGËT.....23

NË BUFENË E BOHEMËVE.....25

QYTETI PA SY.....28

VJESHTA.....30

AI QE DHIMBJA 31

PËRPRAGU 33

KËMBANA E FJALËS 34

SHEGA NË KURORË 35

SELVIA 37

LULESHEGA 39

E MIRA MOJ 41

PIKON NË VESË 42

ATY KU MIZA BREN HEKUR 43

VEÇ NJË ÇAST 44

PËR NË PËRSOSJE 46

DRITARJA 48

LULJA E VERËS 49

VJESHTA 51

NË TINGULLIN E KITARËS 53

PËR TY MIMOZA 54

NJË NATË E GJATË 56

NË KOPËSHT.....57

PËRDITË.....58

NË KOPSHTIN TËND.....59

TË PRISJA.....61

E DASHUR.....63

HIJA E ZOGUT.....65

TRINITETI YNË KOMBËTAR.....69

AI.....71

HERËN E FUNDIT.....73

LULE DHE ZOGJ.....75

UDHËTARI.....77

MBRËMJA ME TY.....78

PRISHTINA.....80

TI ZOG HYJNOR.....81

NATË ME HËNË.....85

TI MOJ LULEMIMOZË.....86

GRUA.....91

NE NUK JEMI ATA 94

BOTA IME..... 95

NËN DRITARE 97

E BARDHA 99

PORTOKAJTË E VERËS..... 101

ATY..... 102

AI DHE GJYSMA E TIJ 104

I TRETURI..... 106

NË BRIGJET E HIJEVE..... 108

SI GJETHI NË SHKËMB 110

NJË DEGË E THATË..... 112

DIKU..... 114

DIKUR..... 115

KURORA E LULES 117

BRAKTISJA 118

RRJEDH LUMI..... 120

TI E TËRA 122

SHENJAT E FLUTURIMIT 124

N`SYRIN E DITËS 125

ZË LUMI 127

VESA NË DORË 129

NËN PJERGULL 130

MUZGU 131

PËRFTIMI 133

DRI` 134

KUJTOHEMI 135

KUR E PASHË 137

FUSHA DHE BRIGJE 138

SY E DRITË 140

PAS MESNATE 141

VESË NË GJETH 143

FILLIM I RI 144

GOTA 145

N`SOKAKUN TONË 147

NDARJA.....149

BREGUT TË DETIT 150

QERSHORI 152

PASIONI 153

NË NJË FJALË.....155

LULEDIMRI.....157

DITA 158

DHOMA.....159

NË HIJEN E DRITËS 160

MOS U BËN !.....161

ULLIRI.....163

JANARI.....165

DRITARJA 166

NATË.....168

NË VIGUN E DRITËS 169

RRETHI I KOHËS 171

TEATËR.....173

PRANVERË 175

PASDITE.....177

MËNGJESI 178

GJYSMËDRITA 180

PAK BIOGRAFI PËR AUTORIN 183